Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 30 dhe 35, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar, të vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", i ndryshuar, dhe urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Ana Kapaj", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

a) Pikat 1 dhe 3 të kreut I/A ndryshojnë si vijon:

"1. Subjekti juridik vendës ose i huaj aplikon nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania", duke plotësuar formularin për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, brenda datës 15 tetor për vitin akademik pasardhës.

…

3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MAS-i, subjekti ngarkon në portalin e-Albania, nëpërmjet numrit të gjurmimit , brenda 15 ditëve, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vetdeklarimin që subjekti, administratori dhe ortaku/ët nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

b) projekt-statutin e institucionit të arsimit të lartë (në vijim IAL), ku përcaktohen detyrimisht strukturat dhe kërkesat e tjera të parashikuara në ligjin nr. 80/2015, "Për

arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";

c) listën e stafit akademik dhe ndihmësakademik, sipas njësive kryesore/njësive bazë ku do të atashohen;

ç) kopje të dëshmive të titujve akademikë dhe diplomave të gradave shkencore, për kategoritë "Profesor" dhe "Lektor", kopje të diplomës "Master i shkencave" për kategorinë "Asistent lektor";

d) aktmarrëveshjet/kontratat për angazhimin e personelit akademik me kohë të plotë, nënshkruar prej tyre me autoritetin drejtues të parashikuar për institucionin e arsimit të lartë;

dh) numrin e studentëve që parashikohet të regjistrohen në programet e studimit në rast hapjeje të IAL-së, i nevojshëm për vlerësimin e standardit mbi raportin personel akademik me kohë të plotë/student, sipas fushave kryesore të studimit, parashikuar në VKM-në nr. 418/2017, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", të ndryshuar;

e) vërtetimin bankar me anë të të cilit subjekti garanton sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare në masën e përllogaritur për studentë të deklaruar për pranim, sipas programit të studimit që do të ofrohet, si garanci e nevojshme për të siguruar cilësinë e programeve të planifikuara të studimeve, si dhe të veprimtarive të tjera të institucionit;

ë) mandatë pagesën prej 30% të shumës së tarifës bazë për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin institucional të llojit të IAL-së, parashikuar në tabelën 2/a, të vendimit nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", të ndryshuar;

f) kopjen e certifikatës së pronësisë së godinës ose kontrata e qirasë/huapërdorjes me afat jo më pak se 3 (tre) vjet, shoqëruar me kopje të skanuar të certifikatës së pronësisë së qiradhënësit;

g) relacionin mbi infrastrukturën e godinës nga eksperti i licencuar, ku detajohen ambientet minimale të nevojshme për hapjen e IAL-ve, sipas natyrës së programeve të studimit që do të ofrohen, që janë si më poshtë:

i. auditorë mësimi;

ii. laboratorë për programin studimit dhe ndjekje praktikash;

iii. ambiente për personelin akademik;

iv. ambiente për personelin administrativ;

v. bibliotekë dhe ambiente për senatin, salla audiovizive, kompjuterësh etj.;

vi. ambiente teknike (që i shërbejnë funksionit të godinës, si: kaldaja, motor gjeneratori, depozita uji dhe elektropompa, depo, kabina elektrike etj.), oborr dhe ambiente të gjelbëruara.

b) Pas pikës 3 të kreut I/A, shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"3/1 Subjekti duhet të disponojë edhe dokumentacionin që MAS-i siguron me ndërveprim nga institucionet përgjegjëse shtetërore, që janë:

a) ekstrakti i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit ose vendimi i regjistrimit nga gjykata kompetente për subjektin juridik, ku të jetë përfshirë arsimi i lartë në objektin e veprimtarisë së tij;

b) leja higjieno-sanitare dhe akti për mbrojtjen nga zjarri.".

c) Pika 3 e kreut I/B ndryshon si vijon:

"3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MAS, institucioni i arsimit të lartë, brenda 15 ditëve, ngarkon në portalin e-Albania, nëpërmjet numrit të gjurmimit, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimet e Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit për miratimin e riorganizimit të llojit IAL-së;

b) listën e programeve të studimit që do të ofrohen në njësitë kryesore dhe njësitë bazë;

c) listën e personelit akademik me kohë të plotë, sipas njësive kryesore dhe njësive bazë, kopje të dëshmive të titujve akademikë dhe diplomave të gradave shkencore, për kategoritë "Profesor" dhe "Lektor", si dhe kopje të diplomës "Master i shkencave" për kategorinë "Asistent lektor";

ç) deklaratën nga titullari i institucionit për plotësimin e standardeve infrastrukturore të IAL-së, sipas kërkesave të përcaktuara në VKM-në nr. 418, datë 10.5.2017, e ndryshuar. Kjo deklaratë shoqërohet me dokumente që vërtetojnë pronësinë ose të drejtën e përdorimit të mjediseve dhe plotësimin e kritereve infrastrukturore, për një periudhë jo më pak se 3 vjet;

d) mandat pagesën prej 30% të shumës së parashikuar për vlerësimin e jashtëm të llojit të IAL-së, sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 109/2017, të ndryshuar".

ç) Pas pikës 3 të kreut I/B, shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"3/1 MAS siguron me ndërveprim, nga institucionet përgjegjëse shtetërore, aktet e hapjes dhe akreditimit të parë/periodik të IAL-së."

d) Pika 1 e pikës I, të kreut I/D ndryshon si vijon:

"1. Mbyllja e institucionit të arsimit të lartë bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave mbi bazë të propozimit të ministrit përgjegjës për arsimin, mbështetur në kërkesën e institucionit të arsimit të lartë.

IAL, deri në 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të vitit akademik, ka të drejtë të aplikojë në platformën e-Albania

dhe plotëson formularin ku argumentohen shkaqet për mbylljen e IAL-së. Në formular plotësohen deklaratat për:

a) shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore dhe taksave vendore, shoqëruar me vërtetimin përkatës nga institucionet përgjegjëse;

b) masat e marra për përfundimin e rregullt të studimeve nga ana e studentëve të IAL-së dhe për pajisjen me dokumentacionin për transferim studimesh të studentëve që nuk kanë përfunduar studimet;

c) përmbushjen e të gjitha detyrimeve financiare kontraktore ndaj studentëve të IAL-së.

Aplikimi duhet të shoqërohet me propozimin e Senatit Akademik dhe miratimin e Bordit të Administrimit për mbylljen e IAL-së."

dh) Pika 2 e pikës I, të kreut I/D, shfuqizohet.

e) Pikat 4 dhe 5 të kreut II/A ndryshojnë si vijon:

"4. Në rast të miratimit të aplikimit në fazën e parë, IAL-ja brenda 15 ditëve ngarkon elektronikisht në portalin e-Albania, nëpërmjet numrit të gjurmimit, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.

Për IAL-të e huaja vendimet e organeve përkatëse të saj duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe të njësuara me origjinalin;

b) vërtetimin bankar me anë të së cilës IAL garanton sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare në masën e përllogaritur për studentë të deklaruar për pranim, sipas programit të studimit që do të ofrohet, si garanci e nevojshme për të siguruar cilësinë e programeve të planifikuara të studimeve, si dhe të veprimtarive të tjera të institucionit;

c) aktin e akreditimit të IAL-së dhe të programeve të studimit që do të ofrohen, në rastin e IAL-ve të huaja;

d) listën e personelit akademik me kohë të plotë, sipas njësisë kryesore/njësisë bazë ku atashohen dhe kopje të dëshmive të titujve akademikë dhe diplomave të gradave shkencore, për kategoritë "Profesor" dhe "Lektor", kopje të diplomës "Master i shkencave" për kategorinë "Asistent lektor";

e) aktmarrëveshjet/kontratat për angazhimin me kohë të plotë nënshkruar nga autoritetet drejtuese të institucionit të arsimit të lartë;

f) deklaratën nga titullari i institucionit për plotësimin e standardeve infrastrukturore të IAL-së;

g) aktin e pronësisë ose të marrjes me qira të objektit ku do të ushtrohet aktiviteti.

5. Dokumentacioni shqyrtohet nga MAS dhe në rast të vlerësimit pozitiv, miratohet akti i hapjes së degës në nivel njësie kryesore dhe/ose në nivel njësie bazë për institucionet e arsimit të lartë me seli qendrore brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, jo më vonë se 2 (dy) muaj nga data e aplikimit."

ë) Pika 3 e kreut IV/A ndryshon si vijon:

"3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MAS-i, IAL-ja, brenda 15 ditëve, ngarkon në portalin e-Albania, nëpërmjet numrit të gjurmimit dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton hapjen e programit/eve të studimit, që duhet të përmbajnë edhe gjuhën në të cilën zhvillohet programi, si dhe kodin e tij.

Në rast se propozimi vjen nga një institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkon financim nga buxheti i shtetit depozitohet miratimi paraprak i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL);

b) mandat pagesën për tarifën që paguhet për vlerësimin nga ekspertët e programit të studimit, sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 109/2017, të ndryshuar;

c) vërtetimin e rektorit për personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme për programin e studimit, që përmban listën emërore, ngarkesën mësimore dhe formën e punësimit, si dhe titullin akademik dhe gradën shkencore përkatëse;

ç) dëshmitë që vërtetojnë shkollimin e kualifikimet, titujt dhe gradat;

d) lejen e punëdhënësit kryesor për anëtarët e personelit akademik me kohë të pjesshme;

dh) rregulloren e programit të studimit;

e) planin mësimor për çdo program studimi;

ë) programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkruara nga titullarët/pedagogët e tyre (për programet profesionale);

f) në rast bashkëpunimi me një institucion tjetër të huaj të arsimit të lartë për hapjen e programeve të përbashkëta të studimit, kërkohet depozitimi në gjuhë shqipe, i përkthyer dhe noterizuar i aktit të akreditimit të institucionit ose të programit të studimit;

g) marrëveshjen specifike për programin e përbashkët të studimit, ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij, si: autorësia dhe pronësia e syllabuseve të depozituara, gjuha dhe metoda e mësimit dhe provimeve, shkëmbimi i stafit pedagogjik, lloji i diplomës etj. Kjo marrëveshje mund të jetë edhe në formën e rregullores së përbashkët mësimore."

f) Pikat 5 dhe 6 të kreut IV/A shfuqizohen.

g) Pika 3 e kreut IV/B ndryshon si vijon:

"3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MAS-i, subjekti ngarkon në portalin e-Albania, nëpërmjet numrit të gjurmimit, brenda 15 ditëve, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton riorganizimin e programit të studimit, që duhet të përmbajnë edhe gjuhën në të cilën zhvillohet programi, si dhe kodin e tij .

b) mandatpagesën për tarifën që paguhet për vlerësimin nga ekspertët e programit të studimit, sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 109/2017, të ndryshuar;

c) vërtetimin nga rektori për personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme për programin e studimit, që përmban listën emërore, ngarkesën mësimore dhe formën e punësimit, si dhe titullin akademik dhe gradën shkencore përkatëse;

ç) dëshmitë që vërtetojnë shkollimin e kualifikimet, titujt dhe gradat;

d) lejen e punëdhënësit kryesor për anëtarët e personelit akademik me kohë të pjesshme;

dh) rregulloren e programit të studimit;

e) planin mësimor ekzistues dhe planin e ri të programit të studimit që riorganizohet;

ë) programet e lëndëve (syllabuset) të nënshkruara nga titullarët/pedagogët e tyre (për programet profesionale);

f) aktin e akreditimit të programit të studimit të institucionit partner të huaj i përkthyer dhe noterizuar (për programe të përbashkëta studimi);

g) marrëveshjen specifike për programin e përbashkët të studimit, ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij, si: autorësia dhe pronësia e syllabuseve të depozituara, gjuha dhe metoda e mësimit dhe provimeve, shkëmbimi i stafit pedagogjik etj. Kjo marrëveshje mund të jetë edhe në formën e rregullores së përbashkët mësimore."

gj) Shkronja "a" e pikës 1, të kreut IV/C ndryshon si vijon:

"a) IAL-ja aplikon në platformën e-Albania, për mbylljen e programit/eve të studimit, jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj para fillimit të vitit të ri akademik, duke paraqitur në formularin e aplikimit shkaqet për mbylljen e programit të studimit, shoqëruar me vendimet përkatëse të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit.

IAL-ja është përgjegjëse për pasojat juridike të ardhura nga mbyllja e programit/eve të studimit për studentët që kanë përfunduar programin apo janë në proces ndjekjeje të programit."

h) Pika 3 e kreut IV/E ndryshon si vijon:

"3. Në rast vlerësimi pozitiv nga MAS-i, IAL-ja, brenda 15 ditëve, ngarkon elektronikisht dokumentacionin e mëposhtëm:

a) projektin kërkimor-shkencor dhe zhvillimit;

b) vendimin e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, që miraton hapjen/riorganizimin e programit/eve të studimit që duhet të përmbajnë edhe gjuhën në të cilën zhvillohet programi (kur zhvillojnë lëndë deri në 30 kredite), si dhe kodin e tij. Në rast se propozimi vjen nga një institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkon financim nga buxheti i shtetit depozitohet miratimi paraprak i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL). Në rast financimi nga vetë IAL-ja, në vendimin e Bordit të Administrimit të IAL-së duhet të jetë e shprehur masa e financimit të plotë gjatë kohëzgjatjes së programit që do të mbulohet nga të ardhurat e IAL-së dhe nuk do të kërkohet financim shtesë nga buxheti i shtetit (për IAL-të publike);

c) aktin e miratimit të financimit të projekteve kërkimore-shkencore nga AKKSHI-ja (në rast se ka);

ç) mandat pagesën për tarifën që paguhet për vlerësimin paraprak nga ekspertët e jashtëm të caktuar sipas përcaktimeve në VKM-në nr. 109/2017, të ndryshuar;

d) dokumentin e grupimit të njësive bazë (akt marrëveshje / akt i organeve kolegjiale, për grupimin e departamenteve / qendrave kërkimore-shkencore) në institucionin e arsimit të lartë, në rast grupimi sipas fushave e nënfushave, të ngjashme ose të përafërta, referuar legjislacionit në fuqi, të përcaktuara në propozimin e programit;

dh) deklarimin për kapacitetet infrastrukturore, si vijon:

i. listën e laboratorëve shkencorë të akredituar ose jo;

ii. listën e bibliotekave të profilizuara dhe kapaciteti fizik i tyre, i shprehur në vende/poste pune kërkimi;

iii. lista e arkivave dhe e koleksioneve shkencore;

iv. listën e abonimeve në revista apo e botimeve shkencore periodike, përshirë dhe ato elektronike;

e) deklarimin për kapacitetet akademike, si vijon:

i. listën e personelit akademik të njësisë bazë apo grupimit të njësive sipas fushave, i kategorisë "Profesor", me numrin e udhëheqjeve/bashkëudhëheqjeve në momentin e paraqitjes së aplikimit, dëshmitë e titujve akademikë dhe kontratat e punës ose vërtetimin e rektorit.

ë) rregulloren e programit të studimeve të doktoratës, e cila përfshin edhe planin e programit të studimit të doktoratës;

f) në rast bashkëpunimi me një institucion tjetër të huaj të arsimit të lartë për hapjen/riorganizimin e programeve të përbashkëta të studimit të doktoratës, së bashku me dokumentacionin e mësipërm, kërkohet depozitimi në gjuhë shqipe, i përkthyer dhe njehsuar me origjinalin të dokumenteve si më poshtë:

i. aktin e akreditimit të programit të studimit;

ii. marrëveshjen specifike për programin e përbashkët të studimit, ku të parashikohen modalitetet e ofrimit të tij, si: autorësia dhe pronësia e syllabuseve të depozituara, gjuha dhe metoda e mësimit dhe provimeve, shkëmbimi i stafit pedagogjik, lloji i diplomës etj. Kjo marrëveshje mund të jetë edhe në formën e rregullores së përbashkët mësimore."

i) Titulli i kreut IV/F dhe paragrafi i parë i pikës 1 të tij, ndryshojnë si vijon:

"F. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR VERIFIKIMIN E KAPACITETEVE AKADEMIKE DHE INFRASTRUKTURORE."

"1. Institucionet e arsimit të lartë, aplikojnë për certifikimin e kuotave në shërbimin përkatës në e-Albania brenda datës 15 prill, kuotat për vitin akademik pasardhës për çdo program studimi, me përjashtim të numrit të udhëheqjeve për programet e studimit për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe ngarkojnë në sistem:

a) vendimin e Senatit Akademik;

b) listën e personelit akademik me kohë të plotë, sipas çdo njësie bazë dhe njësisë kryesore ku atashohen;

c) informacionin mbi të dhënat për numrin e studentëve;

ç) informacionin mbi kapacitetet infrastrukturore të IAL-së, sipas tabelave të përgatitura nga ministria përgjegjëse e arsimit.

2. Për kuotat në programet e studimit për fitimin e gradës shkencore "Doktor", për vitin akademik pasardhës, IAL-ja aplikon brenda datës 31 korrik dhe së bashku me aplikimin ngarkon dokumentacionin shoqërues, sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij."

3. Verifikimi i kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore për kuotat, lidhur me pranimet në programet e studimit për vitin akademik pasardhës, kryhet nga ministria përgjegjëse për arsimin brenda 90 ditëve nga data e aplikimit."

j) Shkronja "c" në shtojcën nr. 1 dhe shkronja "d" në shtojcën nr. 2, shfuqizohen.

k) Fjalia e parë e shkronjës "d", në shtojcën nr. 1, ndryshon si vijon:

"- planin mësimor për çdo program studimi që do të ofrohet, ku përcaktohet fusha përkatëse e arsimit, lëndët e ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese me kreditet përkatëse, në vite e semestra dhe personeli akademik që do të angazhohet në to. Pozicionimi i programit të studimit në lidhje me programet e studimit të ofruar nga IAL-të e tjera".

l) Shkronja "e" në shtojcën nr. 2 dhe pika 5 në shtojcën nr. 3, ndryshojnë si vijon:

"Ky seksion plotësohet për programet e përbashkët të studimit dhe duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

a) burimet financiare dhe kontributin e partnerëve;

b) llojin e diplomës (e përbashkët, e dyfishtë ose e shumëfishtë);

c) të dhëna mbi aktin e akreditimit të institucionit të huaj ose të programit të studimit të vendit të origjinës;

ç) marrëveshjen specifike për programin konkret të studimit."

ll) Pas pikës 5/5, të kreut VI shtohen pikat 5/6 dhe 5/7 me përmbajtje si më poshtë:

"5/6. "Aplikimet për programet e përbashkëta të studimit me institucione të huaja të arsimit të lartë, pranohen deri më 30 prill".

5/7. Aplikimet dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga ministria përgjegjëse për arsimin, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre.".

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Ana Kapaj

UDHËZIM
Nr. 3, datë 20.1.2025

PËR METODAT E KONTROLLIT TË CILËSISË, LIDHUR ME PËRMBAJTJEN E KANABINOIDEVE, SI DHE TË KONTROLLIT FIZIKO-KIMIK DHE MIKROBIOLOGJIK, PËR MËNYRËN E PAKETIMIT, FORMËN DHE SASINË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 28, pika 5, të ligjit nr. 61, datë 20.7.2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale",

UDHËZOJ:

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë metodat e kontrollit të cilësisë, përfshirë ato të kontrollit fiziko-kimik dhe mikrobiologjik për mostrat e bimës së *cannabis*-it, para paketimit të materialit të thatë ose fazave të tjera pasuese, si dhe mënyrën e paketimit, formën dhe sasinë.

Neni 2
Objekti

1. Të gjithë subjektet e lejuara apo të licencuara, në kuptim të ligjit nr. 61/2023, janë të detyruar të kryejnë analizat, për mostrat e bimës së *cannabis*-it, në përputhje me monografitë specifike 3028, sipas përcaktimeve në shtojcën nr. 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi dhe monografitë mbi materialet bimore (2.8) të farmakopesë

evropiane (Eur.Phar) për nivelet totale të kanabinoideve, si: *delta-9 tetrahidrokanabinolit* (THC), *canabidiolit* (CBD) dhe *canabinolit* (CBN); kontrollit fiziko-kimik dhe mikrobiologjik; si dhe analiza të tjera shtesë në përputhje me kërkesat ligjore të vendit importues.

2. Kriteret dhe procedurat lidhur me mënyrën e paketimit, formën dhe sasinë për bimën e *cannabis*-it të tharë, zbatohen në përputhje me monografinë specifike të Eur-Phar, EU- GMP- dhe EU-GACP.

Neni 3
Përkufizime

Të gjithë termat e përcaktuar në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në ligjin nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale".

Për efekt të këtij udhëzimi, përkufizimet shtesë kanë këto kuptime:

1. ⊿9-Tetrahidrokanabinoli (⊿9-Tetrahydrocannabinol, delta-9 *THC*) – është kanabinoid natyral, i cili shfaqet me 4 steroizomere ((-)-trans, (+)-trans, (-)-cis, (+)-cis) dhe gjendet në bimën e *cannabis*-it.

*2. ⊿9- Tetrahidrokanabinoli total (*delta 9- THC *total)* – nënkupton sasinë totale të delta-9 THC dhe delta-9 THCA i llogaritur sipas monografisë specifike të farmakopesë evropiane.

3. Acidi ⊿9-tetrahidrokanabinolik (⊿-9 *Tetrahydrocannabinolic acid*, delta 9- *THCA*) – është përbërës aktiv natyral që gjendet në bimën e *cannabis*-it në formën e pararendësit biosintetik të delta-9 THC-së.

4. Acidi kanabidiolik (*Cannabidiolic acid*, CBDA) – është përbërës aktiv natyral që gjendet në bimën e *cannabis*-it në formën e pararendësit biosintetik të CBD-së.

5. Bimë cannabis-i – nënkupton varietete të ndryshme të bimës, si *cannabis sativa, cannabis indica* dhe *cannabis ruderalis* dhe përfshin të gjitha pjesët e saj.

6. Cannabis – majat e lulëzuara dhe të frutifikuara të bimës së *cannabis*-it prej të cilave nuk është hequr rrëshira.

7. Certifikatë analize – është dokumenti i lëshuar nga laboratori i akredituar, në përputhje me ISO17025 dhe i miratuar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 61/2023.

8. EU-GACP – praktikat e mira evropiane bujqësore dhe të grumbullimit.

9. EU-GMP – praktikat e mira evropiane të fabrikimit.

10. Eur.Phar – farmakopeja evropiane.

11. GLP (praktikat e mira laboratorike) – i referohen një sërë parimesh/rregullash që synojnë të sigurojnë cilësinë, integritetin dhe besueshmërinë e testimeve laboratorike, të cilat zbatohen në planifikimin, kryerjen, monitorimin, regjistrimin, raportimin dhe arkivimin e testimeve të kryera në laborator.

12. Kanabidioli (*Cannabidiol*, *CBD*) – është një nga kanabinoidet natyrale, i cili biosintetizohet kryesisht në stereoizomerin (-)-trans që gjendet në bimën e *cannabis*-it.

13. Kanabinoide – (Cannabinoids) – nënkupton tërësinë e substancave të biosintetizuara në bimën e *cannabis*-it, strukturalisht të ngjashme me THC-në, të cilët kanë afinitet për t'u lidhur me receptorë specifikë në organizmin e njeriut.

14. Kanabinol (Cannabinol, CBN) është metabolit natyral i *delta-9-Tetrahidrokanabinolit.*

15. Kanabinol total – nënkupton sasinë totale të CBN-së dhe CBNA-së, llogaritur sipas monografisë specifike të farmakopesë evropiane.

16. *Mostër* – është një sasi materiali e marrë, në përputhje me një procedurë të miratuar, nga një numër loti për qëllime testimi në laborator.

17. Numër loti – nënkupton një numër identifikues për çdo seri prodhimi, përftuar në të njëjtat kushte.

18. Pasiguri në matje – i referohet një intervali vlerash që shoqëron një rezultat matjeje, duke treguar shkallën e besueshmërisë dhe të saktësisë së këtij rezultati. Ajo jep të dhëna mbi cilësinë dhe vlefshmërinë e rezultateve të matjes dhe shprehet si vlerë numerike (interval), brenda të cilit ndodhet rezultati i matjes, i shoqëruar me një nivel besimi 95%.

19. SOP (procedura standarde operacionale) – është një dokument i detajuar që përshkruan hapat specifikë që duhet të ndiqen për të kryer në detyrë ose proces, në mënyrë të qëndrueshme dhe në përputhje me standardet e përcaktuara.

Neni 4
Metodat e analizës

1. Metodat e analizës për bimën e *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale, për përcaktimin e përqendrimit total të *delta-9 tetrahidrokanabinolit* (THC), të *kanabidiolit* (CBD) dhe të *kanabinolit* (CBN), kontrollit fiziko-kimik dhe atij mikrobiologjik, duhet të jenë në përputhje me farmakopenë evropiane (Eur.Phar), monografia 3028, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, si dhe me kërkesat e vendit importues.

2. Analizat e kryera, sipas pikës 1 të këtij neni, raportohen referuar peshës së thatë të bimës së *cannabis*-it, për:

a) përqendrimin total të delta-9 *tetrahidrokanabinolit* (THC) dhe acidit delta-9 *tetrahidrokanabinolik* (THCA);

b) përqendrimin total të *kanabidiolit* (CBD) dhe të acidit kanabindiolik (CBDA);

c) përqendrimin total të *kanabinolit* (CBN);

d) kontrollin fiziko-kimik, ku përfshihet identifikimi makroskopik, mikroskopik dhe identifikimi me kromatografi me shtresë të hollë me performancë të lartë (HPTLC);

e) kontrollin mikrobiologjik;

f) kontrollin cilësor dhe sasior për praninë e pesticideve;

g) kontrollin për nivelin e metaleve të rënda: arsenik, merkur, plumb dhe kadmium;

h) kontrollin për praninë e mykotoksinave;

i) analiza të tjera të parashikuara në monografitë specifike të farmakopesë evropiane.

3. Rezultatet e analizave dhe pasiguria në matje (e shprehur si vlerë e matur ± pasigurinë në matje) pasqyrohen në certifikatën e analizës ku shprehen kufijtë e sigurisë së matjeve të kryera. Vlera finale e çdo analize konsiderohet vlera e matur, duke i shtuar pasigurinë në matje, në përputhje me metodikën e certifikuar.

4. Për *cannabis*-in industrial, nëse rezultati final i analizimit të mostrës përfaqësuese për vlerën e THC-së është më i lartë se 0,8% e përqendrimit total të THC-së, i gjithë loti që kjo mostër përfaqëson i nënshtrohet asgjësimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 61/2023.

5. Mostra e bimës së *cannabis*-it industrial, e cila është e dokumentuar për qëllim konsumi në njerëz, kafshë, apo kozmetikë, u nënshtrohet të gjitha testeve të cituara në pikën 2 të këtij neni, duke marrë si referencë vlerat e lejuara sipas legjislacionit të vendit importues, specifikisht për konsumin në njerëz, kafshë apo për qëllime kozmetike.

6. Mostra e bimës së *cannabis*-it industrial, që përdoret për sektorët, sipas përcaktimeve në pikën 9 të nenit 3, të ligjit nr. 61/2023, përveç atyre që përfshihen në kategoritë e pikës 5 të këtij neni, u nënshtrohet vetëm analizave në germat "a", "b", "c", "d" sipas pikës 2 të këtij neni.

7. Mbetja e bimës së *cannabis*-it, pas kontrollit të cilësisë, asgjësohet nga laboratori sipas procedurave përkatëse, sipas tipologjisë së mostrës, duke përdorur metodën e djegies mbi 800 gradë ose të asgjësimit me metoda kimike, në përputhje me përshkrimin përkatës në udhëzimin "Për mënyrën e hollësishme të asgjësimit të bimëve të *cannabis*-it".

8. Procedura e asgjësimit të mbetjeve të bimës së *cannabis*-it nga mostra e kontrollit të cilësisë kryhet si vijon:

- Laboratori njofton me shkrim Agjencinë brenda 3 ditëve pune, lidhur me llojin, sasinë, përmbajtjen e THC-së, sipas certifikatës së analizës së lotit të cilit i përket materiali i mbetur i mostrës, metodën për asgjësim që parashikon të kryejë sipas parashikimeve në këtë udhëzim, datën e parashikuar për asgjësim, në përputhje me shtojcën nr. 3 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, si dhe të dhënat identifikuese të laboratorit;
- Agjencia, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e njoftimit nga laboratori, shqyrton njoftimin dhe konfirmon datën e asgjësimit në prezencë të punonjësit të autorizuar të Agjencisë.

9. Subjekti mund të kryejë analiza për qëllime vetëkontrolli në laboratorë të miratuar.

Neni 5
Certifikata e analizës

1. Laboratori fillon kryerjen e analizave brenda 3 (tri) ditëve pune pas marrjes në dorëzim të mostrës, si dhe brenda 2 (dy) ditëve pune pas përfundimit të tyre laboratori lëshon certifikatën e analizës, në përputhje me procedurën specifike të ruajtjes së anonimatit.

2. Certifikata e analizës hartohet në tri kopje, dy prej të cilave, laboratori ia dorëzon zyrtarisht me shkrim Agjencisë, ndërsa një kopje e mban vetë për një periudhë të njëjtë me atë të akreditimit të laboratorit dhe në çdo rast, jo më pak se 3 vjet nga

data e lëshimit të certifikatës së analizës, duke e vënë në dispozicion të çdo inspektimi.

3. Agjencia, brenda dy ditëve pune nga marrja e certifikatës së analizës nga laboratori i miratuar, kryen çkodimin e mostrës së dërguar për analizë dhe i përcjell zyrtarisht subjektit përkatës certifikatën e analizës. Agjencia pasqyron rezultatet e analizës në regjistër.

4. Subjekti duhet të ruajë certifikatat e analizës në mënyrë të sigurt dhe të organizuar, duke përdorur sisteme elektronike dhe/ose fizike të menaxhimit të regjistrimeve, që lehtësojnë gjurmimin.

5. Certifikata e analizës duhet të përmbajë elementet e parashikuara në standardin ISO 17025 dhe numrin identifikues të laboratorit dhe të dhënat e aktit të miratimit të laboratorit për kryerjen e këtyre analizave.

6. Subjekti duhet të ketë një sistem të brendshëm kontrolli të cilësisë me procedurat përkatëse, me qëllim përftimin e bimës së *cannabis*-it, nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare, në përputhje me kërkesat ligjore.

Neni 6
Procedura e ritestimit dhe rimostrimit

1. Subjekti i licencuar ose i lejuar sipas ligjit nr. 61/2023, mund të kundërshtojë rezultatet e analizave, nëse pretendon se një apo disa nga të dhënat në certifikatën e analizës janë të gabuara.

2. Ritestimi dhe rimostrimi nuk mund të kërkohen në rastin kur rezultati i THC-së është 10% më i lartë se vlera e lejuar të THC-së.

3. Në rastin e kundërshtimit të rezultatit, subjekti, brenda dy ditëve pune nga momenti i marrjes së rezultatit, duhet të depozitojë, me shkrim dhe elektronikisht, pranë Agjencisë kërkesën e arsyetuar. Në këto raste, Agjencia shqyrton kërkesën brenda 3 ditëve pune dhe shprehet nëse do të kryhet ritestimi dhe/ose rimostrimi në laboratorin e miratuar.

4. Ritestimi/rimostrimi kryhet vetëm për parametrin/parametrat që devijojnë nga limitet e lejuara. Ritestimi/rimostrimi ndjek të njëjtat procedura dhe metodika si për analizën fillestare dhe rezultatet përkatëse përcillen sipas së njëjtës procedurë si për analizën fillestare.

5. Ritestimi/rimostrimi mund të kërkohet vetëm një herë për çdo lot prodhimi të pakorrigjuar dhe rezultatet e marra konsiderohen si rezultate përfundimtare. Në rastet kur vlerat e analizave të dy testimeve kanë një diferencë më të madhe se 10%, analiza ripërsëritet në një laborator tjetër të miratuar dhe laboratori i parë duhet të përcjellë sqarimet përkatëse për diferencën e vërejtur që del jashtë standardeve të akreditimit. Agjencia ndërmerr veprime konkrete në zbatim të përcaktimeve në kuadrin ligjor në fuqi deri në propozimin për revokimin e miratimit të laboratorit nga ministri.

Neni 7
Veprimet korrigjuese për përmirësimin e parametrave të lotit të bimës së *cannabis*-it që lidhen me nivelin e lagështisë dhe ngarkesën mikrobiale

1. Subjekti i licencuar ose i lejuar sipas ligjit nr. 61/2023, mund të korrigjojë vetëm një herë lotin e bimës së *Cannabis*-it, duke trajtuar materialin për nivelin e lagështisë dhe ngarkesën mikrobiale, në rast se rezultati i analizës nuk përmbush limitet e lejuara lidhur me këta parametra.

2. Veprimet korrigjuese duhet të jenë të parashikuara në procedurat standarde operacionale të subjektit (SOP), të miratuara nga Agjencia, të cilat përfshijnë metoda specifike që nuk ndikojnë në cilësinë e materialit, por rregullojnë nivelet e kontaminimit mikrobial dhe lagështisë, në përputhje me limitet e analizës së kryer.

3. Për mostrën e përzgjedhur nga loti i korrigjuar, realizohet e njëjta procedurë mostrimi dhe/ose ritestimi, e cila do të kryhet për të gjithë parametrat dhe jo vetëm për ato që devijojnë nga specifikimet në analizën fillestare.

4. Rezultatet përfundimtare për mostrën e lotit të korrigjuar janë të pakundërshtueshme.

Neni 8
Paketimi dhe etiketimi

1. Paketimi primar dhe ai sekondar duhet të garantojnë cilësinë dhe sigurinë e materialit bimor, në përputhje me kriteret e mëposhtme dhe me kërkesat shtesë të vendit importues.

2. Ambienti, mënyra sesi realizohet procesi i paketimit dhe kontrolli mbi materialet paketuese për bimën e *cannabis*-it, të cilat tregtohen me qëllim përfundimtar përdorimin për konsum ose në kozmetikë, duhet të jenë në përputhje me udhëzimet e EU-GMP dhe EU-GACP.

3. Në çdo rast, paketimi duhet të plotësojë kërkesat sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

4. Etiketa duhet të ketë ngjyrë uniforme dhe të dallueshme, të tillë që të krijojë kontrast me simbolin e rrezikshmërisë dhe simbolin e standardizuar të *cannabis*-it (në varësi të vendit importues). Etiketa nuk duhet të përmbajë reklamim të produktit dhe të dhëna që shkaktojnë keqinformim të konsumatorit.

5. Gjuha e përdorur në etiketë duhet të jetë e qartë, e kuptueshme dhe lehtësisht e lexueshme. Formati i etiketës dhe i shkrimit, gjuha dhe elementet shtesë të përmbajtjes së etiketës duhet të jenë në përputhje me kërkesat e vendit importues.

Neni 9
Dispozita të veçanta

1. Mënyra dhe sasia e marrjes së mostrave për kryerjen e analizave me metodat e akredituara për kontrollin e cilësisë bëhet në përputhje me përcaktimet e udhëzimit të përbashkët të ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Bujqësisë, sipas përcaktimeve në nenin 37 të ligjit nr. 61/2023.

Neni 10
Dispozita përfundimtare

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjitha institucionet dhe subjektet e përmendura në këtë udhëzim.

2. Shtojca 1 dhe 2 i bashkëlidhen dhe janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

3. Udhëzimi nr. 12, datë 21.5.2024, i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, "Për metodat e kontrollit të cilësisë, lidhur me përmbajtjen e komponentëve të kanabinoidit dhe tetrahidrokanabinolit, si dhe të kontrollit fiziko-kimik dhe mikrobiologjik për mënyrën e paketimit, formën dhe sasinë", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

Shtojca Nr.1

LULJA E *CANNABIS*-IT
Cannabis Flos

Lulesa femërore e tharë, e plotë ose e fragmentuar, e zhvilluar plotësisht e *Cannabis sativa* L.

përmbajtja: nëse një bar bimor duhet t'u përshkruhet pacientëve si produkt mjekësor, sasitë e matura të tetrahidrokanabinolit total dhe kanabidiolit total, përkatësisht, nuk duhet të devijojnë nga vlerat e deklaruara në etiketë me më shumë se ± 10 për qind.

Lloji dominues i THC:

- *tetrahidrokanabinol total, i shprehur si Δ9 -tetrahidrokanabinol*($C_{21}H_{30}O_2$;*M*:314.5): minimumi 5.0 për qind (bima tharë);
- *kanabidiol total, i shprehur si kanabidiol*($C_{21}H_{30}O_2$; *M*: 314.5): maksimumi 1.0 për qind (bima e tharë).

Lloji i ndërmjetëm THC/CBD:

- *tetrahidrokanabinol total, i shprehur si Δ9 -tetrahidrokanabinol*($C_{21}H_{30}O_2$;*M*:314.5): minimumi 1.0 për qind (bima e tharë);
- *kanabidiol total, i shprehur si kanabidiol*($C_{21}H_{30}O_2$; *M*: 314.5): minimumi 1.0 për qind (bima e tharë);
- *raporti total tetrahidrokanabinol / kanabidiol total*: 0.2 deri 5.0 (bima e tharë).

Lloji dominues i CBD:

- *tetrahidrokanabinol total, i shprehur si Δ9 -tetrahidrokanabinol*($C_{21}H_{30}O_2$;*M*:314.5): maksimumi 1.0 për qind (bima e tharë);
- *kanabidiol total, i shprehur si kanabidiol*($C_{21}H_{30}O_2$; *M*: 314.5): minimumi 5.0 për qind (bima e tharë).

PRODHIMI

Nëse bari bimor duhet t'u përshkruhet pacientëve si produkt mjekësor, lulesa pritet në bazë me mbetje minimale të boshtit kryesor (rachis).

A. Në varësi të varietetit, ngjyra e drogës bimore varion nga jeshile e errët në të verdhë të zbehtë ose nga kafe e lehtë në kafe të kuqërremtë. E gjithë lulesa femërore është një lulesë jo e rregullt, dhe jo e dendur, e përbërë nga nënpetale rrethore të zgjatura (rreth 10 mm të gjata) me buzë të dhëmbëzuara, të përziera me lule. Lulëzimi i fragmentuar, përfshin pjesë të boshtit të lules, nënpetale dhe petale, së bashku me lule individuale ose organe të lules. Lulet femërore janë shumë të vogla (rreth 2 mm) me një bisht të shkurtër. Perianthi është monosepaloz dhe pa petale. Sepali shpesh i quajtur si brakteolë, mbështillet rreth vezores njëlokulare, e cila ka dy shtyllëza. Secila përfundon në një krezë të hollë portokalli në ngjyrë kafe që është më e gjatë se kaliksi. Lulesa është pak a shumë e dendur, me trikome mbuluese dhe trikome gjëndrore që prodhojnë një rrëshirë ngjitëse me erë aromatike.

B. Ekzaminimi mikroskopik (*2.8.23*), në drogën bimore të bluar (jo të situr). Ngjyra varion nga jeshile e errët në të verdhë- jeshile ose nga kafe e lehtë në kafe të kuqe. Ekzaminimi nën një mikroskop duke përdorur *tretësirë e kloralhidratit R*. Bari bimori i bluar tregon karakteristikat e mëposhtme diagnostikuese (Figura 3028.-1): trikome të shumta gjëndrore ose mbuluese, të lira ose të ngjitura në epidermë, të llojeve të ndryshme: a) trikome të plota gjëndrore, me një kërcell shumëqelizor dhe një kokë shumëqelizore e mbuluar nga një kutikul me kupolë (seksioni tërthor [E]), ose fragmente të këtyre trikomave që përfshijnë kërcellin ose vetëm kokën [A]; disa kanë një kërcell shumë të shkurtër [Ha], të tjerët janë të palëvizshëm; disa kanë ende kutikulën me kube mbi qelizat e gjëndrave (pamja e sipërfaqes [Da], seksioni tërthor [Ea]) ndërsa të tjerët nuk e kanë më atë [A]; b) trikome të vogla gjëndrore me kërcell njësh ose dysh dhe një kokë një-, dy- ose katërqelizore që përmban pika të verdha në portokalli (pamja e sipërfaqes [Bc, Ca, J], pamja anësore [Cb, La, Lb]); c) trikome mbuluese njëqelizore cistolitike [Fa, Ka] dhe jocistolitike; trikomat mbuluese konike cistolitike
kanë mure të trasha, një bazë të gjerë dhe një fund të lakuar, të mprehtë, me një depozitë karbonat kalciumi qartësisht të dukshme, me gunga, globulare (pamja e sipërfaqes [Ba], seksioni tërthor [Ka]), ose një bazë më të ngushtë dhe mure me gropa të dukshme [Fa]; trikomat mbuluese jo-cistolitike janë më të zgjatura dhe kanë mure të trasha dhe të lëmuara [Hb]; fragmente të epidermës së sipërme të braqeve (gjethe të modifikuara) (pamja e sipërfaqes [B, F, L]) ndonjëherë të mbuluara nga një kutikulë e imët e strijuar e përbërë nga qeliza poligonale me mure të ngurtë [Bb], trikome mbuluese cistolitike [Ba, Fa] dhe trikome të vogla gjëndrore (pamja e sipërfaqes [Bc], pamja anësore [La, Lb]); epiderma e sipërme zakonisht shoqërohet me parenkimë palisad me disa qeliza që përmbajnë kristale të vogla grumbullimi të oksalatit të kalciumit [Bd]; fragmente të epidermës së poshtme të braqeve [D] që përbëhen nga qeliza me mure pak sinuoze [Db], stomata anomocitare (*2.8.3*) [Dc], trikome të vogla gjëndrore [Dd] dhe trikome gjëndrore me kërcell shumëqelizor dhe kokë shumëqelizore [Da]; fragmente të shtresës së braqeve (seksioni tërthor [K]) që përfshin epidermën e sipërme të mbuluar nga një kutikula [Kb], me qeliza drejtkëndëshe dhe trikome mbuluese cistolitike [Ka] dhe shtresën e parenkimës palisadë me disa qeliza që përmbajnë një kristal të vogël grumbulli të oksalatit të kalciumit [Kc]; fragmente të epidermës së poshtme të brakteoleve [H] me qeliza pak të valëzuara [Hc], trikome gjëndrore me kërcell të shkurtër [Ha], stomata anomocitare [Hd], trikome mbuluese jocistolitike [Hb] dhe trikome të vogla gjëndrore [He] ; kristalet e grupeve të voglatë mezofilit themelor janë qartë të dukshme në fragmentet e epidermave të bracteoleve [Hf]; fragmente të stigmave portokalli-kafe që tregojnë qeliza epidermale me mure shumë të imta, pak të dukshme, që përfundojnë në papila të mëdha me një fund të rrumbullakosur [G]; fragmente të boshtit të lulesës [N] që përbëhen nga fibra celuloze, enë spirale [Na] ose unazore dhe qeliza të medulës me

Herbal drugs

muret me rrjetë [Nb], disa prej të cilave përmbajnë kristale grumbullimi të oksalatit të kalciumit me diametër rreth 30 µm; kristalet e grumbullimit të lirë të oksalatit të kalciumit [M].



Figura 3028.-1. -*Ilustrim për testin identifikues B të drogës bimore të prerë ose të bluar të lules së kanabisit*

C. Kromatografia me shtresë të hollë me performancë të lartë (*2.8.25*).

Tretësira e provës. Vendosni 0,5 g të drogës bimore të prerë ose të bluar (jo tësitur) në një provëz dhe shtoni 5,0 ml *metanol R*. Mbylleni tubin dhe përzieni duke përdorur një mikser për 10 s. Centrifugojeni për 5 minuta, më pas përzieni duke përdorur një mikser për 10 s.

Përsëriteni këtë veprim dy herë. Centrifugoni dhe përdorni supernatantin.

Tretësira referencë (a). Shpërndani 5.0 mg të *kanabidiol R* në 1.0 ml të *Δ9- tretësirë tetrahidrokanabinoli R.*

Tretësira referencë (b). Holloni 0,25 ml tretësirë reference (a) në 1,0 ml me *metanol R.*

Tretësira referencë (c). Shpërndani 1 mg të *kanabidiol R* dhe 1 mg të *acid kanabidiolik R* në *metanol R* dhe hollohet në1 ml me të njëjtin tretës.

Shëmues i intensitetit: Tretësirat referencë (a) dhe (b):

– Δ9-tetrahidrokanabinol.

Pllaka: *Silikagel oktadecilsilili TLC F254pllaka R*(2-10 µm).

Faza e lëvizshme:një R,acid acetik glacial R,metanol R (10:10:80*V/V/V*).

Aplikimi: 2,0 µL, si breza prej 8 mm.

Zhvillimi: 70 mm ngabuza e poshtme e pllakës.

Tharja: në një rrymë ajri në temperaturën e dhomës për 5 min.

Zbulimi: me *reagent vanilinë R*, ngroheni në 100 °C për 3 minuta dhemë pas lëreni të ftohet për 3 minuta; ekzaminoni në dritën e ambientit.

Përshtatshmëria e sistemit: tretësira referencë (c):

– kromatograma tregon në të tretën e mesme 2 zona të dallueshme, të cilat mund të jenë te prekëshme; zona e poshtme (acidi kanabidiolik) dhe zona e sipërme (kanabidioli) janë gri të kuqe-vjollcë.

Rezultatet: shih më poshtë sekuencën e zonave të pranishme në kromatogramat e marra me tretësirën referencë (a) dhe tretësirën e provës. Për më tepër, në kromatogramën e marrë me tretësirën e provës mund të jenë të pranishme zona të tjera shumë të zbehta.

Nëse është e pranishme, zona e Acidit Δ9-tetrahidrokanabinolik është më intensive se zona e Δ9-tetrahidrokanabinolit. Nëse është e pranishme, zona e acidit kanabidiolik është më intensive se zona e kanabidiolit.

Kufiri i sipërm i pllakës			
Kanabidioli: Zonë e kuqërremtë në vjollcë		Zonë e kuqërremtë -në vjollcë me ngjyrë të lehtë (kanabidiol) Zonë e kuqërremtë -në vjollcë me Ngjyrë intensive (acid kanabidiolik)	Zonë e kuqërremtë në vjollcë , ngjyre e lehtë (kanabidiol) Zonë e kuqërremtë në vjollcë , ngjyre intensive (acid kanabidiolik)
Δ9-tetrahidrokanabinoli : Zonë e kuqërremtë në vjollcë	Zonë e kuqërremtë në vjollcë e lehtë, ose ekuivalente (Δ9-tetrahidrokanabinoli)	Zonë e kuqërremtë në vjollcë e lehtë (Δ9 -tetrahidrokanabinoli)	Zonë e gri në të kuqërremtë në vjollcë, ngjyrë shumë e lehtë ose mungon (Δ9 -tetrahidrokanabinoli)
	Zonë e kuqërremtë në vjollcë intensive (acidi Δ9 -tetrahidrokanabinolik)	Zonë e kuqërremtë në vjollcë (acidi Δ9-tetrahidrokanabinolik)	Zonë e kuqërremtë në vjollcë, ngjyrë shumë e lehtë (acidi Δ9-tetrahidrokanabinolik)
Tretësira referencë (a)	Tretësira e provës (lloji THC dominant)	Tretësira e provës (lloji THC/CBD i ndërmjetëm)	Tretësira e provës (lloji CBD dominant)

TESTET

CBN totale. Kromatografia e lëngshme (*2.2.29*).

Tretësira e provës (a). Në 0,50 g drogë bimore të prerë ose të bluar (jo të situr) në një tub të përshtatshëm centrifuge të pajisur me një tapë, shtoni 40 ml *etanol (96 përqind) R* dhe tundeni për 15 min. Centrifugojeni në 1700g dhe transferojeni supernatantin e pastër në një balonë. Përsëriteni ekstraktimin dy herë me 25 ml *etanol (96 përqind) R*. Kombinoni supernatantët dhe holloni në 100,0 ml me *etanol (96 përqind) R.* Filtroni përmes një filtri membranor (madhësia nominale e poreve 0,22 µm).

Tretësira e provës (b). Holloni 1,0 ml tretësirë testuese (a) në 10,0ml me *metanol R.*

Tretësira referencë (a). Shpërndani 20,0 mg të *kanabidiol për kanabis CRS* në *metanol R* dhe hollohet në 100,0 ml me të njëjtin tretës.

Tretësira referencë (b). Holloni 5,0 ml tretësirë reference (a)në 20,0 ml me *metanol R.*

Tretësira referencë (c). Holloni 10,0 ml tretësirë reference (a)në 25,0 ml me *metanol R.*

Tretësira referencë (d). Deri në 50 mg lule *cannabis*-i për përshtatshmërinë e sistemit *HRS* në një tub të përshtatshëm centrifuge të pajisur me tapë, shtoni 4 ml *etanol (96 përqind) R* dhe tundeni për 15 min. Centrifugoni tretësirën në 1700g dhe transferojeni supernatantin e pastër në një balonë. Përsëriteni ekstraktimin dy herë me 2,5 ml *etanol (96 përqind) R.* Kombinoni supernatantët dhe holloni në 10 ml me*etanol (96 përqind) R.* Filtroni përmes një filtri membranor (madhësia nominale e poreve 0,22 µm).

Lulja e kanabisit

Shihni seksionin e informacionit për monografitë e përgjithshme të EU. Phar. kopertinës)

Tretësira referencë (e). Holloni 1 ml tretësirë referencë (d) në10 ml me *metanol R*.

Kolona:

- *madhësia: l = 0.15 m, Ø = 4.6 mm;*
- *faza stacionare*: silikagel oktadecilsilil me bërthamë të ngurtë me mbulesë fundore polare për kromatografi R(2.7 µm);
- *temperatura*: 35 °C.

Faza e lëvizshme: 0.1 për qindV/V tretësirë e acidit trifluoroacetik R, acetonitrilit për kromatografi R(41:59V/V).

Shpejtësia e rrjedhjes: 2.0 ml/min.

Zbulimi: spektrofotometër në 228 nm.

Injeksion: 5 µL tretësirë testuese (a) dhe solucione referente (b)dhe (d).

Koha e ekzekutimit: 5.0 herë koha e mbajtjes së kanabidiolit.

Identifikimi i piqeve: përdorni kromatogramën e marrë me tretësirën referuese (b) për të identifikuar pikun e kanabidiolit; përdorni kromatogramin e dhënë me lule *cannabis*-i për përshtatshmërinë e sistemit HRS dhe kromatogramën e marrë me tretësirën referencë (d) për të identifikuar piqet e Δ_9-tetrahidrokanabinolit, acidit Δ_9-tetrahidrokanabinolik, acidit kanabidiolik, kanabinolit, dhe acidit kanabinolik, kanabikromen, kanabigerol dhe acid kanabigerolik.

Mbajtja relative: duke iu referuar kanabidiolit (koha e mbajtjes = rreth 6,9 min): acidi kanabidiolik = rreth 1,10; kanabigerol = rreth 1,17; kanabinol = rreth 1,48; acid kanabigerolik = rreth 1,63; Δ_9-tetrahidrokanabinol = rreth1,76; acid kanabinolik = rreth 2.38; kanabikromen = rreth 2,48; Δ_9-acidi tetrahidrokanabinolik = rreth 2,78.

Përshtatshmëria e sistemit: tretësira referencë (d):

- *rezolucioni*: minimumi 2.0 midis piqeve të acidit kanabigerolik dhe Δ_9-tetrahidrokanabinolit;
- raporti pik-luginë: minimumi 1.5, ku H_p =lartësia mbi vijën bazë të pikut të kanabigerolit dhe Hv = lartësia mbi vijën bazë të pikës më të ulët të kurbës që ndan këtë majë nga piku i acidit kanabidiolik; minimumi 5.0, ku H_p=lartësia mbi vijën bazë të pikut të acidit kanabinolik dhe Hv= lartësia mbi vijën bazë të pikës më të ulët të kurbës që ndan këtë pik nga piku i kanabikromenit.

Llogaritni përmbajtjen e përqindjes së CBN totale, duke përdorur shprehjen e mëposhtme:

$$\frac{((A_1 \times 0{,}405) + (A_3 \times 0{,}901 \times 0{,}876)) \times m_2 \times p}{A_2 \times m_1 \times 4}$$

A_1 = zona e pikut të kanabinolit në kromatogramën e marrë me tretësirën e provës (a);

$A2$ = zona e pikut të kanabidiolit në kromatogramin e marrë me tretësirën referencë (b);

$A3$ = zona e pikut të acidit kanabinolik në kromatogramin e marrë me tretësirën e provës (a);

$m1$ = masa e barit bimor që do të ekzaminohet, e përdorur përpërgatitjen e tretësirës testuese (a), në gram;

$m2$ = masa e *kanabidiolit për cannabis CRS* që përdoret për të përgatitur tretësirën referuese (a), në gram;

p = Përmbajtja e përqindjes së kanabidiolit në *kanabidiol për cannabis CRS*;

0,405 = faktori korrigjues i kanabinolit duke iu referuar kanabidiolit;

0,901 = faktori korrigjues i acidit kanabinolik duke iu referuar kanabidiolit;

0,876 = raporti i masës molekulare të kanabinolit me atë të acidit kanabinolik.

Limiti

- CBN totale, maksimumi 1.0 %

Materiale te huaja(*2.8.2*): maksimumi 2 për qind; nëse materiali bimor duhet t'u përshkruhet pacientëve si produkt mjekesor, ai nuk përmban asnjë farë dhe e gjithë droga bimore nuk përmban gjethe më të gjata se 1.0 cm.

Përcaktimi kryhet duke përdorur 25-50 g.

Humbje gjatë tharjes(*2.2.32*): maksimumi 12,0 për qind, i përcaktuar në 1,000 g drogë bimore të prerë ose të bluar (jo të situr) duke tharë mbi rreth 100 g *sita molekulare R* në një presion midis 1,5 kPa dhe 2,5 kPa në 40 °C për 24 orë.

Arseniku(*2.4.27*): maksimumi 0.2 ppm nëse produkti bimor duhet t'u përshkruhet pacientëve si produkt mjekësor

Kadmium(*2.4.27*): maksimumi 1.0 ppm, ose maksimumi 0.3 ppm nëse produkti bimor duhet t'u përshkruhet pacientëve si produkt mjekësor.

Plumbi(*2.4.27*): maksimumi 5.0 ppm, ose maksimumi 0.5 ppm nëse produkti bimor duhet t'u përshkruhet pacientëve si produkt mjekësor

Mërkuri(*2.4.27*): maksimumi 0,1 ppm.

PËRCAKTIMI SASIOR

Kjo procedurë është vërtetuar për një gamë analitike prej 0,2 për qind deri në 32,0 për qind të Δ_9-tetrahidrokanabinolit, acidit Δ_9- tetrahidrokanabinolik, përkatësisht kanabidiol dhe acid kanabidiolik.

Kromatografia e lëngshme (*2.2.29*) siç përshkruhet në testin përCBN total, me modifikimet e mëposhtme.

Injeksion: tretësira e provës (b) dhe tretësirat referencë (c) dhe (e).

Përshtatshmëria e sistemit: tretësira referencë (e):

- *rezolucioni*: minimumi 2.0 midis piqeve të kanabidiolit dhe acidit kanabidiolik.

Llogaritni përmbajtjen në përqindje të tetrahidrokanabinolit total, të shprehur si $\Delta 9$-tetrahidrokanabinol, duke përdorur shprehjen e mëposhtme:

$$\frac{((A_1 \times 1{,}097) + (A_3 \times 0{,}691 \times 0{,}877)) \times m2 \times p \times 4}{A_2 \times m_1}$$

A = zona e pikut të $\Delta 9$-tetrahidrokanabinolit në kromatogramën e marrë me tretësirën e provës (b);

$A2$ = zona e pikut të kanabidiolit në kromatogramën e marrë me tretësirën referencë (c);

$A3$ = zona e pikut të acidit $\Delta 9$-tetrahidrokanabinolik në kromatogramin e marrë me tretësirën e provës (b);

$m1$ = masa e barit bimor që do të ekzaminohet, e përdorur përpërgatitjen e tretësirës së provës (a), në gram;

$m2$ = masa e *kanabidiol për cannabis CRS* përdoret për të përgatitur tretësirën referuese (a), në gram;

p = Përmbajtja e përqindjes së kanabidiolit në *kanabidiol për cannabis CRS*;

1,097 = faktori korrigjues i Δ_9-tetrahidrokanabinolit duke iu referuar kanabidiolit;

0,691 = faktori korrigjues i Δ_9-acidi tetrahidrokanabinolik në lidhje me kanabidiolin;

0,877 = raporti i masës molekulare të Δ_9-tetrahidrokanabinolnë atë të Δ_9-acidi tetrahidrokanabinolik.

Herbal drugs

Llogaritni përmbajtjen në përqindje të kanabidiolit total, të shprehur si kanabidiol, duke përdorur shprehjen e mëposhtme:

$$\frac{(A_1 + (A_3 \times 0{,}596 \times 0{,}877)) \times m_2 \times p \times 4}{A_2 \times m_1}$$

A_1 = zona e pikut të kanabidiolit në kromatogramin e marrë me tretësirën e provës (b);

A_2 = zona e pikut të kanabidiolit nëkromatogramin e marrë me tretësirën referencë (c);

A_3 = zona e pikut të acidit kanabidiolik në kromatogramin e marrë me tretësirën e provës (b);

$m1$ = masa e barit bimor që do të ekzaminohet, e përdorur përpërgatitjen e tretësirës provë (a), në gram;

$m2$ = masa e *kanabidiolit për cannabis CRS* që përdoret për tëpërgatitur tretësirën referencë (a), në gram;

p = Përmbajtja e përqindjes së kanabidiolit në *kanabidiolpër cannabis CRS*;

0,596 = faktori korrigjues i acidit kanabidiolik duke iu referuar kanabidiolit;

0,877 = raporti i masës molekulare të kanabidiolit me atëtë acidit kanabidiolik.

RUAJTJA

Në një enë hermetike.

ETIKETIMI

Etiketa tregon përmbajtjen në përqindje të tetrahidrokanabinolit total dhe kanabidiolit total.

Përveç kësaj, në etiketë thuhet nëse materiali bimor duhet t'u përshkruhet pacientëve si produkt mjekësor.

Herbal drugs

Shtojcë nr. 2

Kërkesat për paketimin dhe për etiketimin e materialeve të bimës së *cannabis*-it, nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të tij.

I. Paketimi i materialeve të bimës së *cannabis*-it, nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të tij

1. Kriteret e përgjithshme lidhur me paketimin janë si më poshtë:

a) të jetë rezistent ndaj dëmtimeve;

b) të jetë opak dhe i papërshkueshëm nga drita;

c) të parandalojë kontaminimin e *cannabis*-it;

ç) në rastet kur produkti që paketohet është bima e tharë e *cannabis*-it, duhet të garantojë ruajtjen e tij në kushte të thata;

d) të jetë i shoqëruar me elemente sigurie, që garantojnë konsumatorin se produkti i paketuar nuk është hapur para dorëzimit;

dh) të jetë prej materiali inert (kimikisht inaktiv) dhe që nuk çliron substanca në produkt;

e) pjesa e brendshme dhe e jashtme e paketimit nuk duhet të përmbajë asnjë element reklamues të subjektit kultivues apo prodhues;

ë) ngjyra e sipërfaqeve të brendshme dhe të jashtme të paketimit duhet të jetë e njëtrajtshme dhe të plotësojë kriteret e mëposhtme:

i. të mos vishet me shtresë metalike ose të përmbajë elemente metalike në bojë; përjashtohen këtu rastet kur paketimi i brendshëm ose i jashtëm është prej metali;

ii. të mos jetë fluoreshente, ose të ketë përmbajtje fluoreshente në bojë, ose të përmbajë pigmente që absorbojnë rrezatim ultraviolet dhe e çlirojnë si rrezatim me valë më të gjatë (si seria Pantone 800);

iii. duhet të krijojnë kontrast të mjaftueshëm me simbolin që sinjalizon rrezikun për shëndetin dhe simbolin e *cannabis*-it;

f) tekstura e sipërfaqeve paketuese duhet të jetë e njëtrajtshme, pa relieve, riga dekorative, gdhendje apo elemente të tjera parregullsie, përjashtohen këtu elementet e nevojshme për të lehtësuar hapjen e paketimit, ose për të sinjalizuar personat me aftësi të kufizuara;

g) asnjë pjesë e paketimit nuk duhet të përmbajë elemente të fshehura të krijuara për të ndryshuar pamjen e tij, si bojë që aktivizohet në nxehtësi apo elemente të tjera që bëhen të dallueshëm me mjete të tjera teknologjike, përjashtohen këtu elementet që parandalojnë falsifikimin;

gj) sipërfaqja e brendshme ose e jashtme e kontenitorëve mbajtës të produkteve apo paketimi i jashtëm i tyre nuk duhet të përmbajë elemente të krijuar për të ndryshuar sipërfaqen e kontenitorit apo paketimit të jashtëm;

h) paketimi nuk duhet të jetë i tillë që çliron aroma;

i) në paketim duhet të përfshihet dhe elementi i barkodit/kodit të shënjimit-gjurmimit, në format drejtkëndor dhe i printuar në ngjyra bardhezi;

j) paketimi i jashtëm i tij të mos përfshijë në paketim:

i. produkte të tjera ushqimore;

ii. më shumë se një varietet *cannabis*-i;

iii. më shumë se një paketim parësor, përjashtim bëjnë rastet kur paketohen me paketimin parësor produkte ushqimore me përmbajtje *cannabis*-i të ndara në njësi individuale, totali i të cilave nuk kalon limitin e lejuar të THC totale në varësi të vendit importues.

2. Për bimën e *cannabis*-it, që tregtohen me shumicë paketimi:

a) duhet të sigurojë transportin e sigurt të përmbajtjes së tij;

b) realizohet në paketime me vakum ose fuçi të mbyllura hermetikisht dhe rezistente ndaj dritës, për lulet e *cannabis*-it dhe nënproduktet e kanabisit për përdorim të mëtejshëm në industrinë farmaceutike, ushqimore ose atë kozmetike;

c) realizohet në thasë ose me arka të mëdha për pjesët e tjera të bimës së *cannabis*-it, si kërcelli, farat ose nënproduktet e tyre për përdorim industrial, përveç përdorimeve të përmendura në shkronjën "b" të kësaj pike.

3. Për bimën e *cannabis*-it, që do të tregtohen me pakicë, paketimi:

a) duhet të pajiset me vula sigurie;

b) të parandalojë aksesin nga të miturit;

c) të ndahet në mënyrë të tillë që përmbajtja totale e THC-së për dozë ose përmbajtja totale e THC-së për paketim, të mos tejkalojë limitet e vendit importues;

ç) të reflektojë në mënyrë të saktë në etiketë sasinë e THC-së në përmbajtje;

d) të përshtatet me formën dhe me mënyrën e përdorimit të pjesës së bimës së *cannabis*-it, nënproduktit apo produktit që paketohet.

II. Etiketimi i materialeve të bimës së *cannabis*-it, nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare

1. Etiketa duhet të përmbajë elementet e parashikuara në pikën 6 të nenit 28, si dhe karakteristikat e mëposhtme:

a) emërtimi kimik/xhenerik/zyrtar;

b) emërtimi tregtar, nëse ka;

c) nr. i licencës/lejes së subjektit prodhues;

ç) numri i lotit;

d) kushtet e ruajtjes: u referohen elementeve të temperaturës, të dritës ose të lagështisë (p.sh., të ruhet në një vend të thatë, të shmanget drita direkte etj.);

dh) sasia neto e masës së thatë: pesha neto e bimës së *cannabis*-it e shprehur në vlera numerike me njësi gram ose kilogram dhe në kufijtë e tolerancës:

i. për sasi nga 0 g deri në 2 g toleranca në përqindje është 10%;

ii. për sasi më shumë se 2 g toleranca në përqindje është 5%.

e) përqendrimi total i THC-së dhe përqendrimi total i CBD-së, për çdo njësi dhe për të gjithë sasinë e paketuar;

ë) mënyra dhe qëllimi i përdorimit;

f) paralajmërimet për t'u mbajtur larg fëmijëve;

g) paralajmërimet për rreziqet për shëndetin;

gj) përmbajtjen e lëndëve shtesë, nëse ka;

h) përmbajtjen e vlerave ushqyese, burimet e alergjeneve dhe përmbajtjen e sulfiteve, nëse qëllimi i përdorimit është për konsum;

i) barkod/kodi i shënjimit-gjurmimit.

UDHËZIM
Nr. 3, datë 24.1.2025

PËR MËNYRAT DHE PROCEDURAT PËR ZBATIM NGA BIZNESET DHE PROFESIONET E CAKTUARA JOFINANCIARE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 28, pika 3, germa "a", të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë mënyrat dhe procedurat për zbatim nga subjektet e përfshira në veprimtari jofinanciare, në përputhje me sa parashikohet në nenin 3, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar.

Neni 2
Përkufizimet

1. Përkufizimet e parashikuara në nenin 2, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar, zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë për terminologjinë e përdorur në përmbajtjen e këtij udhëzimi. Në rast të konstatimit të ndonjë termi apo togfjalëshi me kuptim tjetër nga ai që parashikon ligji, do të gjejë zbatim terminologjia e parashikuar në ligj.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllim dhe zbatim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:

a) "Raporti i aktivitetit të dyshimtë" (RAD) është formulari elektronik me anë të të cilit subjektet që i nënshtrohen këtij udhëzimi raportojnë tek autoriteti përgjegjës për çdo transaksion dhe aktivitet të dyshimtë, sipas aneksit I "Raporti i aktivitetit të dyshimtë" (RAD), bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi;

b) "Raporti i transaksionit të parasë fizike" (RTPF) është formulari elektronik me anë të të cilit subjektet që i nënshtrohen këtij udhëzimi raportojnë tek autoriteti përgjegjës çdo transaksion në para fizike në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lek ose kundërvlera në monedha të tjera të huaja, të kryer si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën, sipas aneksit II "Raporti i transaksioneve të parasë fizike" (RTPF), bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi;

c) "Raporti i kontrollit në distancë" (RKD) është formulari sipas aneksit III "Raporti i kontrollit në distancë" (RKD), bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi, i cili me kërkesën e autoritetit përgjegjës plotësohet dhe raportohet nga subjektet që i nënshtrohen këtij udhëzimi në lidhje me përmbushjen prej tyre të detyrimeve ligjore;

ç) "Sistemi i centralizuar" është regjistri i brendshëm për regjistrimin dhe mbajtjen e të dhënave mbi klientët dhe transaksionet që plotësohet nga subjektet që i nënshtrohen këtij udhëzimi dhe që përmban të dhënat sipas aneksit IV

"Për regjistrimin dhe mbajtjen e të dhënave mbi klientët dhe transaksionet", bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi;

d) "Burimi i pasurisë" është tërësia e fondeve dhe pasurive që posedon klienti;

dh) "Klient rastësor" është personi i cili është përdorues i shërbimeve të ofruara nga subjektet që i nënshtrohen këtij udhëzimi, edhe për një herë të vetme, gjatë një periudhe 1-vjeçare (njëvjeçare) duke mos vendosur një marrëdhënie vazhduese biznesi me këto subjekte;

e) "Transferta në grup" nënkupton një transfertë që përbëhet nga disa transferta individuale që i dërgohen të njëjtit institucion financiar por që mund të këtë më shumë se një përfitues.

Neni 3
Subjekte të këtij udhëzimi

1. Subjekte të këtij udhëzimi janë si më poshtë:

a) lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet, të çfarëdo forme;

b) avokatët, noterët dhe profesionet e tjera sipas përcaktimeve të nenit 3, germa "gj" e ligjit;

c) agjentët e pasurive të paluajtshme, sipas përcaktimeve të nenit 3, germa "h", e ligjit;

ç) çdo person fizik ose juridik, përveç atyre të përcaktuar në germat "a", "b", "c", të pikës 1, të këtij neni, të cilët merren me:

i. administrimin e aseteve të të tretëve dhe/ose drejtimin e veprimtarive të lidhura me to;

ii. ndërtimet;

iii. biznesin e metaleve e të gurëve të çmuar;

iv. marrëveshjet e garancitë financiare;

v. shitblerjen me ankand të sendeve me vlerë 1 000 000 (një milion) lek ose më shumë;

vi. shitblerjen apo ndërmjetësimin e veprave të artit, përfshirë kur kjo kryhet nga galeritë e artit apo shtëpitë e ankandeve, kur vlera e transaksionit të vetëm apo e transaksioneve të lidhura me njëra-tjetrën është e barabartë apo më e madhe se 1 000 000 (një milion) lek, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën;

vii. magazinimin, shitblerjen apo ndërmjetësimin e veprave të artit, kur kjo kryhet në "zonat e lira", kur vlera e transaksionit të vetëm apo e transaksioneve të lidhura me njëra-tjetrën është e barabartë apo më e madhe se 1 000 000 (një milion) lekë, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën;

viii. sigurimin dhe administrimin e parasë fizike ose titujve lehtësisht të konvertueshëm, në emër të personave të tretë;

ix. veprimtaritë e spedicionit dhe/ose të transportit;

x. tregtimin e mjeteve motorike tokësore, lundruese dhe ajrore;

xi. agjencitë e udhëtimit;

d) çdo person fizik ose juridik, përveç atyre të specifikuar në germat "a", "b", "c", "ç", të pikës 1 të këtij neni, të cilët ofrojnë për një klient shërbimet si më poshtë:

i. vepron si agjent formimi i personave juridikë;

ii. vepron ose cakton dikë tjetër të veprojë si një drejtor ose administrator i një personi juridik, pjesëtar i një ortakërie apo një pozitë të ngjashme lidhur me persona të tjerë juridikë;

iii. siguron një zyrë të regjistruar, akomodim ose adresë për biznesin, adresë zyrtare ose me korrespondencë për një shoqëri tregtare, partneritet, person juridik apo organizime ligjore;

iv. vepron ose cakton dikë tjetër të veprojë si i besuar i një organizimi ligjor ose kryen funksion ekuivalent për një formë tjetër organizimi ligjor;

v. vepron ose cakton dikë tjetër të veprojë si një aksionar dhe/ose ortak i shoqërive që kanë aksione të mbajtësit për një person tjetër;

dh) çdo individ, person fizik apo juridik, që tregton mallra apo shërbime në masën që kryen apo pranon pagesa në para fizike në një shumë prej 1 000 000 (një milion) lekësh ose më shumë, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura;

e) audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar, këshilltarët tatimorë, si dhe çdo person tjetër që merr përsipër të ofrojë drejtpërdrejt apo nëpërmjet personave të tjerë me të cilët ai person ka lidhje ndihmë materiale, asistencë apo këshillim për çështje tatimore, si biznes kryesor apo veprimtari profesionale.

KREU II
VIGJILENCA E DUHUR

Neni 4
Masat e vigjilencës së duhur

1. "Vigjilenca e duhur" është tërësia e masave që duhet të zbatojnë subjektet që i nënshtrohen këtij udhëzimi me qëllim:

a) identifikimin dhe verifikimin e plotë, dhe të saktë të klientit;

b) identifikimin e pronarit përfitues përfundimtar dhe verifikimin e identitetit të tij;

c) të kuptojnë strukturën e pronësisë dhe të kontrollit për klientët që janë persona juridikë apo organizimeve ligjore;

ç) të kuptojnë dhe të mbledhin informacion mbi natyrën dhe qëllimin e transaksionit apo të vendosjes së marrëdhënies së biznesit;

d) të kryejnë monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me klientin dhe analizim të transaksioneve të kryera;

dh) të përcaktojnë profilin e rrezikut të klientit.

Seksioni 1

Neni 5
Identifikimi dhe verifikimi i klientit

1. Subjektet duhet të bëjnë identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit të tij nëpërmjet dokumenteve, të dhënave apo informacioneve të marra nga burime të besueshme dhe të pavarura, për çdo:

a) klient rastësor;

b) klient me të cilin kanë një marrëdhënie të vazhdueshme biznesi.

2. Klient në kuptim të ligjit është çdo:

a) person fizik;

b) person fizik që zhvillon veprimtari fitimprurëse;

c) person juridik privat që zhvillon veprimtari fitimprurëse;

ç) person juridik privat që nuk zhvillon veprimtari fitimprurëse;

d) organizim ligjor;

dh) përfaqësues ligjor, përfaqësues i autorizuar apo me prokurë i klientit;

3. Identifikimi i klientit, verifikimi i identitetit të tij dhe statusi i tij ligjor sigurohet nëpërmjet dokumenteve:

a) origjinale;

b) ose dokumenteve elektronike që plotësojnë kushtet e vlefshmërisë, sipas legjislacionit në fuqi për dokumentin elektronik dhe nënshkrimin elektronik.

4. Subjektet duhet të verifikojnë identitetin e klientit përpara ose gjatë vendosjes së marrëdhënies së biznesit, ose kryerjes së një transaksioni për klientët rastësorë.

5. Verifikimi i identitetit të klientit dhe pronarit përfitues mund të kryhet pas vendosjes së marrëdhënies së biznesit, me kusht që verifikimi:

a) të realizohet sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur;

b) të mos çojë në ndërprerjen e aktivitetit normal të zhvillimit të biznesit; dhe

c) rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të menaxhohen në mënyrë efektive, në përputhje me masat e përcaktuara në nenin 4/1 të ligjit.

Neni 6
Identifikimi elektronik i klientit

1. Identifikimi elektronik i klientit, mund të kryhet nga subjektet e këtij udhëzimi nëpërmjet identifikimit elektronik të sigurt, në përputhje me kërkesat e ligjit të fushës "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", vetëm në rastet kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) identiteti i klientit verifikohet në bazë të një dokumenti zyrtar identifikimi biometrik të pajisur me fotografi;

b) klienti jorezident është mbi 18 vjeç;

c) klienti nuk ka vendbanimin apo dokumenti i tij i identifikimit nuk është lëshuar nga vende me rrezik të lartë.

2. Përpara futjes në përdorim të sistemit të identifikimit elektronik, subjektet duhet të vlerësojnë rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në lidhje me këtë lloj procesi, si dhe të marrin masat e duhura e të efektshme për të parandaluar rrezikun që lidhet me transaksionet apo marrëdhëniet e biznesit të kryera pa praninë fizike të klientit.

Neni 7
Dokumentacioni për identifikimin dhe verifikimin e klientit person fizik

1. Identifikimi dhe verifikimi i identitetit të klientit person fizik kryhet me anë të një prej dokumenteve të mëposhtëm:

a) letërnjoftim ID (kartë identiteti);

b) pasaportë.

2. Për personin fizik të huaj rezident:

a) pasaportë;

b) letërnjoftim ID (kartë identiteti) lëshuar sipas kuadrit ligjor në fuqi për të huajt;

c) leje qëndrimi biometrike lëshuar sipas kuadrit ligjor në fuqi për të huajt.

3. Për personin fizik jorezident:

a) pasaportë;

b) letërnjoftim ID (kartë identiteti) për vendet që lejohet të udhëtojnë në Republikën e Shqipërisë me anë të këtij dokumenti sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4. Për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të klientit person fizik, subjektet duhet të regjistrojnë dhe të mbajnë edhe të dhënat e mëposhtme:

a) vendbanimi i përhershëm dhe i përkohshëm (nëse ka);

b) punësimin.

Neni 8

Dokumentacioni për identifikimin dhe verifikimin e klientit që zhvillon veprimtari fitimprurëse

1. Për kategorinë e klientit person fizik që zhvillon veprimtari fitimprurëse dhe klientit person juridik privat që zhvillon veprimtari fitimprurëse për identifikimin dhe verifikimin e tij, dhe statusin e tij ligjor, kërkohen dokumentet e mëposhtëm:

a) dokumenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

b) vendimi i gjykatës, statuti dhe akti i themelimit, nëse ka;

c) certifikata e regjistrimit të personit të tatueshëm të lëshuar sipas kuadrit ligjor në fuqi ku pasqyrohet numri i NUIS/NIPT;

ç) adresa e vendit kryesor të ushtrimit të veprimtarisë, si dhe adresa e degëve të ushtrimit të veprimtarisë, nëse ka.

2. Për kategorinë e klientëve të parashikuar në pikën 1 të këtij neni të cilët janë jorezidentë kërkohen dokumentet e mëposhtëm:

a) dokumentacioni që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në vendin e rezidencës;

b) statuti i shoqërisë, nëse ka;

c) dokumentin ekuivalent të regjistrimit të personit të tatueshëm (NUIS/NIPT) në vendin e rezidencës;

ç) adresën e vendit kryesor të ushtrimit të veprimtarisë, si dhe adresën e degëve të ushtrimit të veprimtarisë, nëse ka.

3. Për këtë kategori klientësh subjektet identifikojnë dhe verifikojnë nëse çdo person që vepron në emër të klientit është përfaqësues ligjor apo i autorizuar i tij. Identifikimi dhe verifikimi i identitetit të tij dhe statusit i tij ligjor kryhet sipas dokumentacionit të kërkuar në nenin 11 të këtij udhëzimi.

Neni 9

Dokumentacioni për identifikimin dhe verifikimin e klientit që nuk zhvillon veprimtari fitimprurëse

1. Për personin juridik privat që nuk zhvillon veprimtari fitimprurëse, për identifikimin dhe verifikimin e statusit të tij ligjor subjektet kërkojnë dokumentet e mëposhtëm:

a) aktin e themelimit dhe statutin;

b) vendimin e gjykatës;

c) certifikatën e regjistrimit të personit juridik me numrin NUIS/NIPT, të lëshuar sipas kuadrit ligjor në fuqi;

ç) selinë e përhershme, adresën e vendit kryesor të veprimtarisë apo degëve ku ushtrohet veprimtaria.

2. Për personin juridik privat jorezident që nuk zhvillon veprimtari fitimprurëse për identifikimin dhe verifikimin e statusit të tij ligjor kërkohen dokumentet e mëposhtëm:

a) akti i themelimit, statuti, vendimi i gjykatës apo dokumentacioni ekuivalent përkatës sipas vendit të origjinës;

b) certifikatën e regjistrimit të personit juridik ose dokument ekuivalent sipas vendit të origjinës.

3. Për këtë kategori klientësh subjektet identifikojnë dhe verifikojnë nëse çdo person që vepron në emër të klientit është përfaqësues ligjor apo i autorizuar i tij. Identifikimi dhe verifikimi i identitetit të tij, dhe statusit i tij ligjor kryhet sipas dokumentacionit të kërkuar në nenin 11 të këtij udhëzimi.

Neni 10

Dokumentacioni për identifikimin dhe verifikimin e organizimeve ligjore

1. Subjektet e këtij udhëzimi për klientët që janë organizime ligjore duhet:

a) të identifikojnë dhe verifikojnë statusin ligjor nëpërmjet:

i. dokumenteve të themelimit;

ii. dokumenteve të regjistrimit ose fakteve të ngjashme të ekzistencës së tyre;

iii. formën ligjore;

iv. adresën e ushtrimit të veprimtarisë;

b) të sigurojnë informacion thelbësor dhe të verifikojnë të dhënat dhe dokumentacionin për:

i. themeluesit;

ii. përfituesit;

iii. kujdestarin apo personin që ushtron kontroll faktik mbi to;

iv. të mirëbesuarit;

v. agjentët e tjerë të rregulluar dhe ofruesit e shërbimeve, përfshirë këshilltarët, menaxherët, kontabilistët dhe këshilltarët tatimor;

vi. drejtuesit dhe/ose përfaqësuesit ligjorë (për personat juridikë) dhe dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet juridike;

c) verifikojnë nëse çdo person që vepron në emër të organizimit ligjor është i autorizuar dhe të identifikojnë, dhe të verifikojnë identitetin e tij;

ç) në rastin e përfituesve të trusteve ose organizimeve ligjore, të përcaktuara në bazë të karakteristikave të veçanta apo klasës, duhet të marrin informacion të mjaftueshëm rreth përfituesit në mënyrë që të garantohet identifikimi i përfituesit në momentin e kryerjes së pagesës apo të ushtrimit të të drejtave nga përfituesi.

2. Subjektet e këtij udhëzimi identifikojnë dhe verifikojnë identitetin, dhe statusin ligjor sipas kërkesave në pikën 1 të këtij neni, nëpërmjet dokumentacionit të parashikuar në nenet 7, 8, 9 dhe 11 të këtij udhëzimi.

Neni 11

Dokumentacioni për identifikimin dhe verifikimin e përfaqësuesit ligjor, përfaqësuesit të autorizuar apo me prokurë të klientit

1. Subjektet e këtij udhëzimi përcaktojnë për të gjithë klientët, para vendosjes së marrëdhënieve të biznesit apo gjatë procesit të monitorimit të kësaj marrëdhënieje, nëse ata janë duke vepruar në emër të një personi tjetër dhe të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e atij personi dhe verifikimin e të dhënave.

2. Subjektet e këtij udhëzimi verifikojë nëse çdo person që vepron në emër të klientit të tij është i autorizuar dhe identifikojnë e verifikojnë identitetin e tij, dhe statusin e tyre ligjor të dhënat e përfaqësuesit ligjor, përfaqësuesit të autorizuar apo me prokurë të klientit nëpërmjet:

a) aktit të përfaqësimit;

b) dokumentacionit të parashikuar në nenet 7, 8, 9, 10 dhe 12 të këtij udhëzimi.

Neni 12

Dokumente shtesë për identifikimin dhe verifikimin e klientit

1. Subjektet mund të kërkojnë nga klienti, rezident apo jorezident, por pa u kufizuar vetëm në to, sipas nevojës për identifikimin dhe për verifikimin e identitetit dhe statusit ligjor të klientit, si dhe në të gjitha rastet kur ka të dhëna ose dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit, dokumentet si më poshtë:

a) Për personat fizikë dhe përfaqësuesit ligjorë:

i. certifikata të lëshuara nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;

ii. leje drejtimi të automjetit;

iii. libreza apo kontrata pune, vërtetim pune apo dokument tjetër që provon marrëdhënien e punës;

iv. kontrata e blerjes apo qirasë së banesës;

v. kontrata me operatorë shërbimesh, si: telefon fiks, celular, energji elektrike, për shërbime ujësjellës-kanalizime, të tjera;

vi. vërtetim vendbanimi të lëshuar nga autoritetet vendore;

b) Për personat fizikë dhe juridikë privat që zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:

i. leje, autorizim, vërtetim apo licencë për ushtrimin e veprimtarisë, nëse ka;

ii. kontrata e blerjes apo qirasë së selisë dhe vendit të ushtrimit të aktivitetit;

c) Për personat juridikë që nuk zhvillojnë veprimtari fitimprurëse:

i. leje, autorizim, vërtetim apo licencë për ushtrimin e veprimtarisë, nëse ka;

ii. kontrata e blerjes apo qirasë së vendit të ushtrimit të aktivitetit.

2. Subjekte, përveç sa është parashikuar në pikën 1 të këtij neni, mund të kërkojnë çdo dokument tjetër që vlerësohet e nevojshme në kuadër të procesit të identifikimit dhe verifikimit të klientit.

Neni 13

Identifikimi dhe verifikimi i pronarit përfitues

1. Subjektet e këtij udhëzimi duhet të kryejnë identifikimin dhe verifikimin e identitetit të pronarit

apo të pronarëve përfitues të klientëve të tyre nëpërmjet dokumenteve të mëposhtëm:

a) dokumentacionit të parashikuar në nenet 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 të këtij udhëzimi;

b) ekstraktit të regjistrit të pronarëve përfitues;

c) informacioneve ose të dhënave të siguruara nga burime të besueshme, në bazë të të cilave subjekti sigurohet për identitetin e pronarit përfitues.

2. Në ato raste kur nuk ekziston regjistri i pronarëve përfitues në vendin e origjinës, subjekti kryen verifikimet e pronarit përfitues sipas dokumentacionit të pronësisë së paraqitur nga klienti.

3. Subjektet verifikojnë të dhënat që zotërojnë për pronarët përfitues me të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues. Në rast të mospërputhshmërisë së të dhënave që subjekti administron, sipas pikës 1 të këtij neni, me të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, subjekti zbaton detyrimet e përcaktuara në nenin 6, të ligjit nr. 112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues", të ndryshuar.

4. Subjektet mund t'i referohen, për përcaktimin e pronarit përfitues të klientëve të tyre, shembujve të dhënë në aneksin V "Shembuj orientues për përcaktimin e pronarit përfitues", bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Seksioni 2

Neni 14

Struktura e pronësisë dhe e kontrollit të klientit

1. Subjektet duhet të kuptojnë strukturën e pronësisë për klientët që janë persona juridikë apo organizime ligjore nëpërmjet:

a) aktit të themelimit, statutit dhe vendimit të gjykatës për regjistrimin e personit juridik sipas kuadrit ligjor në fuqi;

b) ekstrakteve të regjistrit tregtar (vendas ose të huaj);

c) dokumentacionit të mbledhur në kuadër të identifikim dhe verifikimit të pronarit përfitues;

ç) diagramit të pronësisë së ofruar nga klienti dhe dokumentacionit të paraqitur prej tij.

2. Subjektet mund të sigurojnë dokumente të tjera shtesë, në kuadër të këtij neni, nëpërmjet:

a) raporteve të pavarura të auditit;

b) aksesit në data bazat apo regjistra ndërkombëtarë (*Worldcheck*, *Factiva*, *Lexus Nexus*, etj.);

c) faqes zyrtare të internetit të klientit;

ç) informacionit publik të përftuar nga palë të treta (p.sh.: noter publik, ekspert kontabël, avokat etj.);

d) informacionit të dhënë nga klienti për takimet e nivelit drejtues, procesverbalet, listat e autorizimeve dhe delegimi hierarkik i përgjegjësive ose çdo dokument tjetër që mund ta lejojë atë të identifikojë strukturën e pronësisë dhe pronësinë përfituese.

3. Subjektet përcaktojnë se cilët janë individët që zotërojnë ose kontrollojnë klientin, përfshirë ata persona të cilët ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv mbi personin juridik apo organizimin ligjor, si më poshtë:

a) për personat juridikë kjo duhet të përfshijë edhe identifikimin e individëve, të cilët përbëjnë pjesën vendimmarrëse dhe administruese të personit juridik dhe mbajtjen e të dhënave të veprimeve të ndërmarra, si dhe të çdo vështirësie të hasur gjatë procesit të verifikimit;

b) në rast të organizimeve ligjore, kjo përfshin edhe identifikimin e themeluesit, të përfituesit, të kujdestarit ose të personit me një kontroll faktik mbi to.

4. Subjektet përcaktojnë për të gjithë klientët, para vendosjes së marrëdhënieve të biznesit apo gjatë procesit të monitorimit të kësaj marrëdhënieje, nëse ata janë duke vepruar në emër të një personi tjetër dhe të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e atij personi dhe verifikimin e të dhënave.

5. Subjektet verifikojë nëse çdo person që vepron në emër të klientit të tij është i autorizuar dhe identifikojnë, dhe verifikojnë identitetin e tij.

6. Për personat juridikë kjo duhet të përfshijë edhe identifikimin e individëve, të cilët përbëjnë pjesën vendimmarrëse dhe administruese të personit juridik dhe mbajtjen e të dhënave të veprimeve të ndërmarra, si dhe të çdo vështirësie të hasur gjatë procesit të verifikimit. Në rast të organizimeve ligjore, kjo përfshin edhe identifikimin e themeluesit, të përfituesit, të kujdestarit ose të personit me një kontroll faktik mbi to.

Neni 15
Mbledhja e informacionit mbi qëllimin e transaksionit dhe vendosjen e marrëdhënies së biznesit

1. Subjektet duhet të mbledhin informacion mbi qëllimin dhe natyrën e kryerjes së transaksionit apo të vendosjes së marrëdhënies së biznesit, mbi bazën e të cilit duhet të krijojnë profilin e rrezikut të klientit.

2. Subjektet krijojnë profilin e rrezikut të klientit ndaj të cilit zbatohet vigjilenca e duhur, sipas nenit 4/1 të ligjit, për t'u siguruar për qëllimin dhe natyrën e caktuar të marrëdhënies së biznesit apo kryerjes të transaksionit, duke kryer një apo disa nga hapat e mëposhtme:

a) kërkojnë dokumentacion mbështetës mbi burimin e fondeve dhe mundësive financiare të klientit si:

i. kontrata punësimi;

ii. vërtetim page;

iii. kontrata shitblerje apo qiraje, të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme;

iv. kontrata dhurimi;

v. akte ligjore të përfitimit të pasurive me trashëgimi, si dhe dokumente të tjera mbështetëse;

vi. akte të tjera kalimi pronësie të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme;

b) mbledhin informacion në burime të hapura për klientët, si:

i. kërkimet në faqet *web* nëpërmjet platformave të internetit[1];

ii. mediave të shkruar apo audiovizive;

iii. burime të tjera;

c) mbledhin dhe verifikojnë informacionin e përftuar nga klienti në regjistrat publik, si:

i. regjistrin tregtar;

ii. regjistrin e pronarëve përfitues;

iii. regjistrin e organizatave jofitimprurëse;

iv. apo regjistra të tjerë publik;

ç) vlerësojnë kapacitetin financiar të klientit nëpërmjet dokumenteve të vëna në dispozicion nga klienti, si dhe të dhënave publike në regjistrin tregtar, si:

i. pasqyrat financiare për subjektet tregtare;

ii. vendimet e shpërndarjes së dividentit për personat juridik;

iii. informacione të tjera të vlefshme.

3. Subjektet ruajnë dokumentacionin dhe informacionet e përftuara sipas hapave më lart, në përputhje me nenet 36 dhe 37 të këtij udhëzimi.

Neni 16
Monitorimi i vazhdueshëm i klientit, transaksioneve dhe marrëdhënies së biznesit

1. Subjektet duhet të kryejnë monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me klientin. Ky monitorim duhet të përfshijë analizimin e transaksioneve të kryera gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kësaj marrëdhënieje, për t'u siguruar se ato janë në përputhje me njohuritë që subjekti ka për klientin, natyrën e biznesit të tij dhe profilin e rrezikut, si dhe burimin e fondeve.

2. Subjektet duhet të sigurohen, nëpërmjet rishikimit të dosjeve të klientëve, që dokumentet, të dhënat dhe informacioni i mbledhur gjatë procesit të vigjilencës së duhur përditësohet dhe është i vlefshëm dhe i përshtatshëm.

3. Subjektet duhet t'i kushtojnë vëmendje të shtuar klientëve apo marrëdhënieve të biznesit me persona juridik me pronësi indirekte[2] dhe klientëve që kategorizohen me rrezik të lartë, veçanërisht kur ka të dhëna se situata faktike e klientit ka ndryshuar.

4. Subjektet duhet të kryejnë monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me klientin dhe shqyrtimit të vazhdueshëm të transaksioneve.

5. Në rastin e një marrëdhënieje të vazhdueshme me klientin subjektet përditësojnë të dhënat dhe informacionin e marrë, sa herë që është e nevojshme, bazuar në masat e vigjilencës së duhur, monitorimin e kësaj marrëdhënie dhe profilin e rrezikut të klientit. Përveç kësaj, subjektet verifikojnë të dhënat dhe informacionin e marrë në kuadër të vigjilencës së duhur, përfshirë të dhënat e strukturës së pronësisë ligjore dhe pronësisë përfituese, për klientët e tyre, jo më pak se:

a) 1 herë në vit për klientët me rrezik të lartë;

b) 1 herë në 3 vjet për klientët me rrezik të mesëm;

c) 1 herë në 5 vjet për klientët me rrezik të ulët.

[1] *Google* ose motor kërkimi të ngjashëm, të tjerë.

[2] Sipas përkufizimit të ligjit që ka objekt regjistrimin e pronarëve përfitues.

Neni 17
Profili i rrezikut të klientit

1. Subjektet krijojnë profilin e rrezikut të klientit për të kuptuar qëllimin dhe natyrën e kryerjes së transaksionit, vendosjes së marrëdhënies së biznesit apo gjatë monitorimit të vazhdueshëm.

2. Profili i rrezikut ju shërben subjekteve për të përcaktuar dhe zbatuar masat e vigjilencës së duhur dhe asaj të zgjeruar ndaj klientit.

3. Në vlerësimin e profilit të rrezikut të klientit subjektet bazohen në të dhënat e përftuara në kuadër të vigjilencës të thjeshtuar, të duhur apo/dhe të zgjeruar.

Neni 18
Pamundësia në ushtrimin e masave të vigjilencës së duhur

1. Nëse subjektet janë të paafta që të zbatojnë detyrimet e vigjilencës së duhur ndaj klientit:

a) nuk duhet të hapin llogari, të fillojnë një marrëdhënie biznesi apo të kryejnë transaksione;

b) duhet të dërgojnë raport të aktivitetit të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës.

2. Në rastet kur subjekti ka filluar marrëdhënien e biznesit dhe si rezultat i mosparaqitjes së dokumenteve nga ana e klientit ose për arsye të tjera, është i paaftë të plotësojë detyrimin e vigjilencës së duhur, subjekti duhet të përfundojë marrëdhënien e biznesit dhe duhet të dërgojë raport të aktivitetit të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës.

Seksioni 3
Masa të tjera

Neni 19
Zhvillimet teknologjike

1. Subjektet duhet të zbatojnë politika dhe të marrin masat e duhura, sipas rastit, për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që lidhen me:

a) zhvillimet e produkteve të reja, praktikat e biznesit, mënyrat e ofrimit apo kanalet e shpërndarjes;

b) përdorimin e teknologjive të reja apo atyre që janë në zhvillim.

Këto masa duhet të zbatohen përpara futjes në përdorim të produkteve të reja dhe praktikave të biznesit apo teknologjive të reja, për produktet e reja dhe ekzistuese, në mënyrë që të administrohen dhe të ulen rreziqet e identifikuara.

2. Subjektet duhet të zbatojnë procedura specifike dhe të marrin masat e duhura e të efektshme për të parandaluar rrezikun që lidhet me transaksionet apo marrëdhëniet e biznesit, të kryera pa praninë fizike të klientit.

Neni 20
Mbështetja në palë të treta

1. Subjektet, në mbështetje të nenit 6/1 të ligjit, mund të mbështeten në palët e treta për të kryer masat e parashikuara në ligj dhe në këtë udhëzim me kusht që të sigurohen për përmbushjen e kritereve, si më poshtë:

a) subjekti që mbështetet në një palë të tretë duhet të jetë në gjendje të marrë menjëherë informacionin e nevojshëm për sa lidhet me masat e vigjilencës së duhur dhe dokumentacionit të kërkuar për identifikimin dhe verifikimin e klientit;

b) subjekti duhet të marrë masat e duhura për t'u siguruar se kopjet e të dhënave identifikuese dhe dokumentacioni tjetër përkatës lidhur me detyrimet për vigjilencën e duhur të vihen në dispozicion menjëherë nga pala e tretë, sipas kërkesave të vetë subjektit apo autoriteteve përkatëse në zbatim të ligjit;

c) subjekti duhet të sigurohet se:

i. pala e tretë është e rregulluar me ligj, pra veprimtaria që ushtron pala e tretë është e përcaktuar rregullisht në kuadrin përkatës ligjor;

ii. pala e tretë mbikëqyret apo monitorohet nga autoriteti përkatës për sistemin parandalues të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Në këtë kuptim pala e tretë është e licencuar dhe mbikëqyret nga autoriteti përkatës;

iii. pala e tretë ka strukturë kontrolli të brendshëm të ngarkuar edhe me kontrollin e përputhshmërisë me këto detyrime. Në këtë kuptim, pala e tretë duhet të respektojë dhe të garantojë kërkesat e ligjit dhe të këtij udhëzimi në lidhje me kontrollin e brendshëm;

iv. pala e tretë ka marrë masat e përshtatshme për përputhjen me kërkesat për masat e vigjilencës së duhur dhe ruajtjes së të dhënave, sipas përcaktimeve të ligjit dhe këtij udhëzimi. Në këtë kuptim, pala e tretë duhet të respektojë dhe të garantojë kërkesat e ligjit dhe të këtij udhëzimi, në lidhje masat e

vigjilencës së duhur, administrimit dhe ruajtjes së dokumentacionit.

2. Subjektet e këtij udhëzimi që mbështeten në palët e treta, duhet që përpara vendosjes së marrëdhënies me klientin, përveç kritereve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, të marrin në konsideratë edhe kriteret e mëposhtme:

a) gjatë vendosjes së marrëdhënies me palët e treta jashtë vendit duhet të merret në konsideratë edhe informacioni në dispozicion mbi nivelin e rrezikut të atij vendi;

b) ndalohet mbështetja në palë të treta të krijuara në vende me rrezik të lartë përveç nëse pala e tretë është një degë ose filial përfaqësimi me pronësi të shumicës së aksioneve të subjektit, të krijuar në Shqipëri sipas politikave dhe procedurave të shoqërisë mëmë, të cilat janë në përputhje me ligjin;

c) ndalohet mbështetja në palë të treta për rastet e parashikuara në ligj;

ç) ndalohet mbështetja në palë të treta kur kjo vendoset nga autoriteti përgjegjës.

3. Në çdo rast, nëse detyrimet nuk përmbushen nga palët e treta, përgjegjësia ligjore mbetet e subjektit të këtij udhëzimi që mbështetet te pala e tretë.

KREU III
VIGJILENCA E ZGJERUAR

Neni 21
Masat e vigjilencës së zgjeruar

1. Vigjilenca e zgjeruar duhet të përfshijë masa shtesë, përveç atyre të parashikuara për vigjilencën e duhur, për marrëdhëniet e biznesit, klientëve apo transaksionet me rrezik të lartë.

2. Në funksion të zbatimit të vigjilencës së zgjeruar, subjektet e këtij udhëzimi duhet të marrin masat e mëposhtme:

a) të kuptojnë dhe testojnë profilin e klientit, të biznesit dhe veprimtarisë së tij lidhur me shërbimet, produktet dhe transaksionet e ofruara nga subjekti;

b) të identifikojnë informacionet me rëndësi dhe të vlerësojnë rrezikun e mundshëm për pastrim parash/financim terrorizmi, në mbështetje të vendimeve që synojnë mbrojtjen nga rreziqet financiare, rregullatore apo reputacionale, si dhe përshtatjen ndaj kërkesave ligjore;

c) të zbatojnë masat e vigjilencës së zgjeruar në marrëdhëniet e biznesit, klientët dhe transaksionet e përcaktuara sipas nenit 8 të ligjit.

Neni 22
Kategoritë e klientëve, transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit ndaj të cilëve zbatohet vigjilenca e zgjeruar

1. Subjektet duhet të zbatojnë masat e vigjilencës së zgjeruar për marrëdhëniet e biznesit, klientët dhe transaksionet e përcaktuara në nenin 8 të ligjit, për:

a) personat e ekspozuar politikisht (PEP), përfshirë anëtarët e familjes, personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi të personave të ekspozuar politikisht sipas përkufizimeve të pikave 10, 10/1 dhe 10/2, të nenit 2 të ligjit;

b) organizatat jofitimprurëse;

c) organizimet ligjore;

ç) marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me klientët jorezidentë, të vlerësuara me rrezik të lartë;

d) shoqëri që kanë aksione të mbajtësit;

dh) me të gjitha kategoritë e klientëve, të cilët banojnë ose e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vende për të cilat kërkohet marrja e masave të posaçme, sipas përcaktimeve apo kërkesave të autoritetit përgjegjës apo për klientë për të cilët kërkohet kjo masë;

e) me të gjitha vendet me rrezik të lartë të përcaktuara nga autoriteti përgjegjës apo Këshilli i Ministrave;

ë) për të gjitha transaksionet komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor;

f) përfituesit e policave të sigurimit të jetës. Kjo kategori transaksionesh apo marrëdhënie biznesi do të konsiderohet nga subjektet paraprakisht si një faktor rreziku për të përcaktuar zbatimin ose jo të masave të vigjilencës së zgjeruar.

2. Për zbatimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientëve, subjektet mund të kërkojnë praninë fizike të klientëve dhe të përfaqësuesve të tyre para se të vendosin një marrëdhënie biznesi.

Neni 23
Kategori të tjera ndaj të cilëve zbatohet vigjilenca e zgjeruar

1. Krahas kategorive të përcaktuara në nenin 22 të këtij udhëzimi, subjektet mund të përcaktojnë kategori të tjera marrëdhëniesh biznesi, klientësh, transaksionesh, produktesh, shërbimesh, kanalesh

shpërndarjeje, vende ose zona gjeografike të vlerësuara me rrezik të lartë ndaj të cilave duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar.

2. Në zbatim të pikës 1, të këtij neni, subjektet duhet të hartojnë dhe zbatojnë procedura, dhe politika për të identifikuar shkallën e rrezikut sipas kategorive të klientëve apo marrëdhënieve të biznesit. Këto procedura dhe politika duhet të jenë në përputhje me aktivitetin e subjektit dhe në përpjesëtim me rrezikun e identifikuar.

3. Politikat dhe procedurat e subjekteve duhet të bazohen në:

a) rrezikun që paraqet klienti, pozitën e tij gjeografike dhe tërësinë e produkteve dhe shërbimeve;

b) politikën e pranimit të klientëve dhe monitorimin e marrëdhënies së biznesit;

c) procesin e kategorizimit të të gjithë klientëve sipas nivelit të rrezikut.

Neni 24

Masat e vigjilencës së zgjeruar për personat e ekspozuar politikisht

1. Subjektet e këtij udhëzimi përfshijnë në rregulloret dhe procedurat e brendshme, metodat e vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut të klientit, marrëdhënies së biznesit dhe transaksioneve për të përcaktuar, ndër të tjera, nëse një klient apo pronar përfitues i klientit është person i ekspozuar politikisht.

2. Në lidhje me sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjektet:

a) duhet të kërkojnë informacion në burimet e disponueshme, të tilla si: lista e përditësuar e personave të ekspozuar politikisht vendas, bazat specifike të të dhënave (*Worldcheck*, *Factiva* etj.), si dhe burimet e hapura të informacionit;

b) duhet të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit apo vazhdimin e këtyre marrëdhënieve kur një klient ekzistues bëhet person i ekspozuar politikisht;

c) duhet të kryejnë një monitorim në rritje dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me këta klientë;

ç) duhet të marrin masat e duhura për të përcaktuar burimin e pasurisë dhe burimin e fondeve.

3. Për anëtarët e familjes, personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi të personave të ekspozuar politikisht zbatohen të njëjtat masa të parashikuara në këtë nen.

Neni 25

Masat e vigjilencës së zgjeruar për organizatat jofitimprurëse

1. Subjektet përfshijnë në rregulloret dhe procedurat e brendshme politikat e vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut të marrëdhënies së biznesit me klientë të cilët janë organizata jofitimprurëse.

2. Në lidhje me sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjektet:

a) duhet të kërkojnë dhe marrin të dhëna mbi natyrën e veprimtarisë, administrimit dhe drejtimit të tyre, si dhe burimin e fondeve;

b) duhet të analizojnë një informacion të tillë nëpërmjet zbatimit të procedurave të menaxhimit të rrezikut;

c) duhet të kryejnë një monitorim në rritje dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me këta klientë.

Neni 26

Masat e vigjilencës së zgjeruar për marrëdhëniet e biznesit apo transaksionet që përfshijnë vendet me rrezik të lartë

1. Në lidhje me marrëdhëniet e biznesit apo transaksionet që përfshijnë vendet me rrezik të lartë, sipas shkronjës "f", të nenit 22 të ligjit, subjektet duhet të zbatojnë masat e mëposhtme të vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit:

a) të marrin informacion shtesë për klientin dhe pronarin përfitues;

b) të marrin informacion shtesë për natyrën e marrëdhënies së biznesit;

c) të marrin informacion për burimin e fondeve dhe burimin e pasurisë së klientit dhe pronarit përfitues;

ç) të marrin informacion për arsyet e transaksioneve të synuara ose të kryera;

d) të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen ose vazhdimin e marrëdhënieve të biznesit;

dh) të kryejnë monitorim të zgjeruar të marrëdhënieve të biznesit duke rritur numrin, shpeshtësinë apo periodicitetin e kontrolleve të aplikuara dhe zgjedhjen e modeleve të

transaksioneve që kanë nevojë për kontroll të mëtejshëm.

2. Marrja e informacionit shtesë përfshin, por pa u kufizuar vetëm në to:

a) identifikimin dhe verifikimin e klientit apo pronarit përfitues nga burime të hapura dhe të pavarura për të kuptuar më mirë sfondin, pronësinë dhe situatën financiare të klientit ose palëve të tjera në transaksion, apo reputacionin e tregut lokal përmes rishikimit të burimeve mediatike[3];

b) marrja e informacionit dhe verifikimi i burimit të fondeve apo pasurisë së klientit dhe pronarët përfitues të tij, duke u përqendruar në informacionin e përcjellë nga të dhënat e grupeve bankare dhe/ose financiare apo nga institucionet e inteligjencës financiare;

c) kërkimi i informacionit shtesë nga klienti për qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit.

3. Krahas masave të mësipërme, subjektet zbatojnë një ose më shumë nga masat shtesë lidhur me klientët apo transaksionet që përfshijnë vende me rrezik të lartë:

a) zbatojnë elemente shtesë të vigjilencës së zgjeruar;

b) përdorin mekanizma të përmirësuar për raportime apo raportim sistematik të transaksioneve financiare te personi/strukturat përgjegjëse brenda subjektit;

c) kufizojnë marrëdhëniet e biznesit ose transaksionet me individët apo persona fizikë/ juridikë nga vendet me rrezik të lartë.

Neni 27

Masat e vigjilencës së zgjeruar për transaksionet komplekse, me vlera të larta të pazakonta, pa qëllim të dukshëm ekonomik dhe ligjor

1. Subjektet duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor dhe njëkohësisht të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla.

2. Subjektet, për të analizuar arsyet dhe qëllimin e kryerjes të transaksionit/ve të tilla, sipas pikës 7, të nenit 8 të ligjit dhe për mbajtjen e të dhënave për arritjen në konkluzionet me shkrim, duhet të:

a) kërkojnë dokumentacion mbështetës mbi burimin e fondeve, të pasurisë dhe mundësive financiare të klientit, si:

i. kontrata punësimi;

ii. vërtetim page;

iii. vërtetim të kontributeve të sigurimeve shoqërore apo shëndetësore;

iv. kontrata shitblerjeje apo qiraje, të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme;

v. kontrata dhurimi;

vi. akte ligjore të përfitim të pasurive me trashëgimi apo dokumente të tjera të ngjashme;

vii. dokumente të tjerë që vlerësohen të domosdoshëm nga subjekti në përputhje me natyrën e transaksionit dhe profilit të klientit;

b) mbledhin informacion në burime të hapura apo abonime të posaçme për klientët, si:

i. kërkimet në faqet *web* nëpërmjet platformave të internetit[4];

ii. mediave të shkruar apo audiovizive, të tjera;

c) mbledhin dhe verifikojnë informacionin e përftuar nga klienti në regjistrat publik, si:

i. regjistrin tregtar;

ii. regjistrin e pronarëve përfitues;

iii. regjistrin e organizatave jofitimprurëse;

iv. regjistra të tjerë ku subjektet kanë akses;

ç) vlerësojnë kapacitetin financiar të klientit nëpërmjet dokumenteve të vëna në dispozicion nga klienti, si dhe të dhënave publike në regjistrin tregtar, si:

i. pasqyrat financiare për subjektet tregtare;

ii. vendimet e shpërndarjes së dividentit për pronarët;

iii. informacione të tjera të vlefshme.

3. Subjektet gjatë analizimit të transaksioneve komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor, duhet të marrin në konsideratë treguesit e pasqyruar në aneksin VI "Tregues për analizimin e transaksioneve me vlera të larta, të pazakonta, pa qëllim të dukshëm ekonomik dhe ligjor",

[3] Raportet ndërkombëtare të vlerësimit të vendit përfshirë raportet e DASH-it, Indeksi i Bazelit, Raportet e BE-së, FMN-së, e të tjera.

[4] *Google* ose motor kërkimi të ngjashëm.

bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi, por pa u kufizuar vetëm në to.

4. Subjektet ruajnë dokumentacionin dhe informacionet e përftuara sipas hapave të mësipërm dhe ia bashkëngjisin konkluzioneve me shkrim. Administrimi dhe ruajtja e dokumentacionit mbahet në përputhje me nenet 36 dhe 37 të këtij udhëzimi.

KREU IV
DETYRIMET PËR RAPORTIM

Neni 28
Raportimi i aktiviteteve të dyshimta tek autoriteti përgjegjës

1. Subjektet i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, në të cilin parashtrojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit apo fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale. Raportimi bëhet me anë të formularit (RAD) menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

Ky raportim kryhet pas shqyrtimit të plotë të elementeve të dyshimta dhe të dhënave që subjektet kanë në dispozicion për të arsyetuar atë, pavarësisht shumës së transaksionit/ transaksioneve.

2. Kur subjekti, ka dyshime se transaksioni mund të përfshijë pastrim të produkteve të veprës penale, financim terrorizmi apo fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale, ai duhet të mos e kryejë transaksionin, t'ia raportojë menjëherë rastin autoritetit përgjegjës dhe të kërkojë udhëzime nëse duhet ta kryejë apo jo transaksionin. Brenda 48 orëve nga marrja dijeni, autoriteti përgjegjës kthen përgjigje, duke parashtruar qëndrimin për lejimin e transaksionit ose nxjerrjen e urdhrit të bllokimit.

Kur autoriteti përgjegjës nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, subjekti mund të vazhdojë me kryerjen e transaksionit.

3. Formulari (RAD) duhet të shoqërohet me të gjithë informacionin e nevojshëm, që mbështet dyshimet e parashtruara në raport, si dhe lejon nxjerrjen e konkluzioneve përkatëse, si: analizën e kryer, nxjerrjen e llogarisë bankare, dokumentet e identifikimit, të dhënat e transfertave, kontratat, informacione të tjera, dhe dërgohet i plotë në rrugë elektronike, si dhe me shkresë zyrtare nëse raportimi elektronik është objektivisht i pamundur. Raportimi në rrugë elektronike, kryhet bazuar në standardet, formatin dhe aksesin që autoriteti përgjegjës i siguron, sipas kërkesës së bërë për këtë qëllim subjektit.

4. Në raste urgjente, subjektet mund ta përcjellin me telefon informacionin për aktivitetin e dyshimtë tek autoriteti përgjegjës, duke përmbushur më pas detyrimet sipas pikave 1 dhe 3 të këtij neni.

Neni 29
Raportimi i transaksioneve të parasë fizike

1. Subjektet, në përputhje me pikën 3, të nenit 12 të ligjit, janë të detyruara të raportojnë tek autoriteti përgjegjës, brenda ditës pasardhëse të punës nga data e kryerjes së të gjitha transaksioneve në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lek, ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja, kryer si një transaksion të vetëm, ose në disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 24 orëve. Nga ky detyrim përjashtohen transaksionet që kryhen nga organet apo ndërmarrjet publike.[5]

2. Në funksion të zbatimit të pikës 1 të këtij neni, subjektet e këtij udhëzimi do të konsiderojnë si të kryera në para fizike çdo transaksion që nuk është i shoqëruar me një dokument justifikues nga një institucion financiar apo dokumente të tjera justifikuese.

3. Subjektet noter përjashtohen nga detyrimi për raportim brenda afateve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, ekskluzivisht vetëm në ato raste kur transaksioni për kalimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme, kryhet nëpërmjet një institucioni financiar, në një datë të mëvonshme nga data e lidhjes së aktit noterial, për sa është parashikuar edhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të rregullave për trajtimin e transaksioneve financiare të noterit.

4. Raportimi nga subjektet i transaksioneve sipas këtij neni kryhet në rrugë elektronike sipas standardeve dhe formatit të përcaktuar nga autoriteti përgjegjës.

5. Subjektet raportojnë në rrugë elektronike. bazuar në aksesin që autoriteti përgjegjës u siguron sipas kërkesës së bërë për këtë qëllim. Në rastet kur kjo nuk është e mundur, ky raportim mund të kryhet me shkresë zyrtare.

[5] Persona juridik publik.

6. Autoriteti përgjegjës konfirmon marrjen e të dhënave të raportuara, nëse një gjë e tillë kërkohet nga subjekti.

KREU V
MASAT PARANDALUESE TË NDËRMARRA NGA SUBJEKTET

Neni 30
Rregullorja dhe udhëzimet e brendshme

1. Subjektet e këtij udhëzimi duhet të hartojnë rregulloren dhe/ose udhëzime të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke përfshirë, ndër të tjera, marrjen e masave dhe procedurave:

a) për politikën për pranimin e klientit;

b) për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut në marrëdhëniet e biznesit, klientët apo transaksioneve;

c) për zbatimin e masave për vigjilencën e duhur, të thjeshtuar dhe atë të zgjeruar ndaj klientit në përputhje me nivelin e rrezikut;

ç) për mbajtjen e të dhënave;

d) për raportimin e aktivitetit të dyshimtë dhe transaksioneve mbi pragun e raportimit, trajnimin e punonjësve të tyre.

2. Subjektet duhet të përditësojnë në vazhdimësi rregulloret dhe udhëzimet e brendshme duke marrë në konsideratë edhe:

a) ndryshimet ligjore;

b) vlerësimet kombëtare të riskut;

c) vlerësimet sektoriale apo të dhëna të tjera të ngjashme;

ç) të dhënat që ka vetë subjekti;

d) rekomandimet e autoritetit përgjegjës dhe/ose autoriteteve mbikëqyrëse;

dh) si dhe vlerësime ose raporte të hartuara nga organizata ndërkombëtare dhe autoritete me kompetencë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për sa i përket rrezikut që përbëjnë vende të veçanta.

Neni 31
Vlerësimi i rrezikut

1. Subjektet që zbatojnë këtë udhëzim duhet të identifikojnë, të vlerësojnë dhe të kuptojnë rreziqet e tyre të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për:

a) klientët;

b) vendet apo zonat gjeografike;

c) produktet;

ç) shërbimet;

d) transaksionet;

dh) kanalet e shpërndarjes.

2. Subjektet duhet të hartojnë dhe dokumentojnë vlerësimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dhe miratimi i tij bëhet nga niveli drejtues.

3. Me dokumentin e vlerësimit të rrezikut njihen të gjithë punonjësit e subjektit, të cilët kanë detyra funksionale në kuadrin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

4. Vlerësimi i rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duhet t'i nënshtrohet një rishikimi periodik, i cili ndër të tjera bazohet në:

a) ndryshimet e aktivitetit të subjektit;

b) ndryshimet në profilin e rrezikut të klientit;

c) vënien në përdorim të produkteve, shërbimeve, teknologjive dhe kanaleve të reja të shpërndarjes;

ç) ndryshimet ligjore apo rregullatore.

5. Vlerësimi i rrezikut duhet të përditësohet të paktën çdo dy vjet ose sa herë që faktorët e sipërpërmendur diktojnë një gjë të tillë.

6. Faktorët minimalë që duhet të merren në konsideratë në vlerësimin e rrezikut janë qëllimi i vendosjes së marrëdhënies së biznesit, apo madhësia e transaksioneve, rregullshmëria ose kohëzgjatja e marrëdhënies së biznesit.

7. Gjatë procesit të hartimit të vlerësimit të rrezikut subjektet duhet të marrin në konsideratë:

a) vlerësimet kombëtare të rrezikut;

b) vlerësimet sektoriale apo të dhëna të tjera të ngjashme;

c) rekomandimet e autoritetit përgjegjës dhe autoriteteve mbikëqyrëse;

ç) si dhe vlerësime ose raporte të hartuara nga organizata ndërkombëtare dhe autoritete me kompetencë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për sa i përket rrezikut për vende të veçanta.

Neni 32
Struktura përgjegjëse

1. Subjektet e këtij udhëzimi duhet të krijojnë një strukturë përgjegjëse për të parandaluar përdorimin e subjektit për pastrim parash dhe financim të terrorizmit.

2. Subjektet duhet të emërojnë një person përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave në nivele administrimi në zyrën qendrore dhe në çdo zyrë përfaqësimi, filial, degë ose agjenci, tek të cilët të gjithë punonjësit raportojnë çdo fakt që mund të përbëjë dyshim për pastrim parash ose financim terrorizmi dhe të përcaktojnë procedura të përshtatshme menaxhimi e përputhshmërie, brenda subjektit dhe degëve.

3. Personi përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit duhet të jetë drejtues ose punonjës me njohuri të mjaftueshme për rrezikun e ekspozimit ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të subjektit dhe të ketë kompetencë për të marrë vendime që ndikojnë në ekspozimin ndaj rrezikut dhe që nuk nevojitet në të gjitha rastet të jetë anëtar i bordit të drejtorëve apo i këshillit mbikëqyrës.

4. Personi përgjegjës i emëruar në nivel administrimi në zyrën qendrore, sipas parashikimeve të pikës 2, të këtij neni, është personi që dërgon raportet tek autoriteti përgjegjës, në përputhje me nenin 12 të ligjit, si dhe u kthen përgjigje kërkesave të autoritetit përgjegjës.

5. Në rast se numri i punonjësve të subjekteve është më pak se tre persona, person përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave është administratori ose një punonjës i autorizuar i subjektit.

6. Në rastin kur subjektet e këtij udhëzimi janë të vetëpunësuar, të cilët nuk kanë të punësuar persona të tjerë, për efekt të zbatimit të këtij udhëzimi veprojnë në cilësinë e strukturës përgjegjëse.

7. Kur një individ, që bën pjesë në kategoritë e parashikuara në nenin 3 të ligjit, ushtron veprimtarinë profesionale si i punësuar i një personi juridik apo personi fizik tregtar ose ka një marrëdhënie kontraktuale ose nënkontraktuale me ta, person përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave është punëdhënësi.

Neni 33

Sistemi i centralizuar për regjistrimin dhe mbajtjen e të dhënave

1. Subjektet duhet të krijojnë një sistem të centralizuar i cili të mundësojë regjistrimin, grumbullimin, analizimin, kontrollin e të dhënave dhe transaksioneve në kuadër të marrëdhënies së biznesit me klientin. Në sistemin e centralizuar regjistrohen të gjitha transaksionet, pavarësisht nga mënyra e kryerjes së tyre (si p.sh në para fizike, nëpërmjet shërbimit të transfertës së parasë apo vlerave apo transfertave të drejtpërdrejta elektronike, akte dhurimi, shkëmbimi etj.).

2. Në sistemin e centralizuar subjektet e këtij udhëzimi për klientët rastësor regjistrojnë çdo transaksion në një shumë të barabartë me jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, kryer në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën. Nëse shuma e transaksioneve nuk dihet në kohën e veprimit, identifikimi duhet të kryhet sapo të bëhet e ditur shuma dhe të arrihet pragu i mësipërm.

3. Përjashtimisht, për subjektet e këtij udhëzimi lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet të çfarëdo forme, duhet të regjistrojnë në sistemin e centralizuar edhe çdo transaksion për një shumë të barabartë ose më të madhe 100 000 (njëqind mijë) lekë ose kundra vleftën e saj në monedhë të huaj.

4. Subjektet, nëse e vlerësojnë të nevojshme, në funksion të menaxhimit të riskut, mund të mbajnë në sistemet e tyre të centralizuara edhe të dhënat për transaksionet nën pragjet e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

5. Në të gjitha rastet, pavarësisht sa parashikuar në pikat e mësipërme, regjistrohen të dhënat në sistemin e centralizuar kur ka dyshime për pastrim parash, financim terrorizmi apo fondet/pasuria e përfshirë rrjedh nga veprimtari kriminale.

6. Sistemi i centralizuar duhet të përmbajë së paku të dhënat sipas aneksit IV "Për regjistrimin dhe mbajtjen e të dhënave mbi klientët dhe transaksionet", bashkëlidhur këtij udhëzimi, me elementet si vijon:

a) emri (i klientit);
b) mbiemri;
c) datëlindja;
d) vendlindja;
e) nr. personal i identifikimit (NID);
f) lloji i dokumentit;
g) emri i shoqërisë;
h) NIPT/NUIS;
i) adresa;
j) shuma e transaksionit;
k) monedha;
l) lloji i transaksionit (p.sh. derdhje/tërheqje/ transfertë);
m) data e transaksionit;

n) mënyra e kryerjes së transaksionit (p.sh. *cash* (para fizike)/transfertë);

o) burimin e deklaruar të fondeve;

p) persona të tjerë të përfshirë në transaksion, nëse ka (me gjeneralitete të plota);

q) për personat juridik të dhënat identifikuese për pronarët përfitues të klientit.

7. Të dhënat e identifikuara duhet të jenë të mbështetura në dokumentacion justifikues dhe nëse kërkohet, të vihen në dispozicion të autoritetit përgjegjës, autoriteteve mbikëqyrëse dhe audituesve. Përjashtohen nga detyrimi për dokumentacion justifikues të dhënat: adresa dhe burimi i deklaruar i fondeve. Ky përjashtim është i aplikueshëm vetëm për mbajtjen e të dhënave në funksion të sistemit të centralizuar.

8. Nëse këto të dhëna nuk mbahen në sistem të posaçëm elektronik, duhet të jenë të përpunueshme, për shembull me anë të programeve Excel, *Access*, apo programe të tjera teknologjike të përshtatshme për ruajtjen e të dhënave.

9. Autoriteti përgjegjës, me qëllim verifikimin e të dhënave të pasqyruara në sistemin e centralizuar, kërkon nga subjektet që i nënshtrohen këtij udhëzimi në përputhje me nenin 21/1 të ligjit, çdo informacion, të dhënë apo dokument tjetër mbështetës.

Neni 34
Trajnimet

1. Subjektet duhet të trajnojnë periodikisht punonjësit e tyre sipas një plani vjetor të trajnimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë këtu edhe njohjen me ndryshimet ligjore në këtë fushë, si dhe detyrimin për mosdeklarim sipas nenit 15 të ligjit.

2. Subjektet, në zbatim të këtij detyrimi, duhet të mbajnë së paku të dhënat mbi:

a) numrin vjetor të trajnimeve të planifikuara dhe të kryera;

b) numrin e punonjësve të trajnuar, si dhe funksionet e tyre;

c) çështjet e trajtuara në to.

3. Këto të dhëna i paraqiten autoritetit përgjegjës, si dhe autoriteteve mbikëqyrëse në kuadrin e inspektimeve në vend apo në distancë.

Neni 35
Kontrolli i brendshëm

1. Subjektet, në përputhje me germën "dh", të nenit 11 të ligjit, duhet të marrin masat parandaluese për zbulimin dhe korrigjimin e mangësive të gjetura për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet e ligjit dhe të këtij udhëzimi.

2. Në rastet kur subjektet raportuese janë të vetëpunësuar ose të cilët nuk kanë të punësuar persona të tjerë, për efekt të zbatimit të këtij neni administratori apo i autorizuari prej tij veprojnë në cilësinë e kontrollit të brendshëm.

Neni 36
Administrimi i dokumentacionit

1. Subjektet që i nënshtrohen zbatimit të këtij udhëzimi duhet të mbajnë në dosjen e klientit dokumente:

a) origjinale;

b) të njehsuara me origjinalin;

c) kopje të njehsuara nga vetë subjekti të këtyre dokumenteve.

2. Kur dokumentet mbahen kopje të njehsuara nga vetë subjekti, këto dokumente duhet të jenë të vulosura me vulën e subjektit dhe të firmosura nga vetë subjekti, që vërteton se janë të njëjta me dokumentet origjinale të paraqitura nga klienti, duke përmbajtur edhe datën e prodhimit të tyre.

3. Kur subjekti mban arkiv elektronike, përveç dokumenteve origjinale elektronike, në arkiv duhet të mbahen në formë elektronike, kopje të njehsuara nga vetë subjekti, që vërteton se janë të njëjta me dokumentet origjinale të paraqitura nga klienti.

Neni 37
Detyrimet e mbajtjes dhe të ruajtjes së të dhënave

1. Subjektet duhet të ruajnë dokumentet që rrjedhin nga procesi i vigjilencës së duhur dhe asaj të zgjeruar, të dhënat e llogarive, transaksioneve, korrespondencën me klientin, si dhe rezultatet e analizave të kryera për 5 vjet nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit apo nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga data e secilit transaksion apo data e mbledhjes së dokumentacionit apo kryerjes së analizës.

2. Subjektet duhet të mbajnë regjistra për të dhënat, raportimet dhe dokumentacionin për transaksionet kombëtare dhe ndërkombëtare, pavarësisht nëse transaksioni është kryer në emër të klientit ose në emër të palëve të treta, së bashku me të gjithë dokumentacionin mbështetës, përfshirë dosjet e llogarive dhe korrespondencën e biznesit, për 5 (pesë) vjet nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit apo nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga data e secilit transaksion në veçanti apo data e mbledhjes së dokumentacionit, apo e kryerjes së analizës.

3. Subjektet duhet të ruajnë të dhëna për transaksionet, përfshirë edhe ato të përcaktuara në nenin 10 të ligjit, me të gjitha hollësitë e duhura për të lejuar rindërtimin e ciklit të plotë të transaksioneve, me qëllim sigurimin e informacionit për autoritetin përgjegjës dhe për autoritetet e tjera kompetente, në bazë të ligjit e të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Ky informacion ruhet për 5 (pesë) vjet nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit apo nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga data e secilit transaksion në veçanti apo data e mbledhjes së dokumentacionit, apo e kryerjes së analizës.

4. Subjekteve u kërkohet që të dhënat e detyrueshme për t'u mbajtur mbi transaksionet e kryera dhe klientët e tyre, t'i ruajnë në mënyrë të saktë dhe kronologjike, pa korrigjime, që të mundësojnë kontrollin adekuat nga autoriteti përgjegjës, autoritetet mbikëqyrëse/licencuese dhe audituesit, nëse kërkohet.

5. Subjektet duhet të ruajnë dokumentacionin për identifikimin, llogaritë, si edhe korrespodencën me klientin. Subjektet duhet të ruajnë, gjithashtu, të dhënat mbi analizat që kanë kryer për të vlerësuar klasifikimin e marrëdhënieve të biznesit në bazë rreziku, si dhe analizat e procesit të monitorimit.

6. Dokumentacioni ruhet për 5 vjet nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit apo nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga data e secilit transaksion apo data e mbledhjes së dokumentacionit, apo kryerjes së analizës.

7. Me kërkesë të autoritetit përgjegjës dhe të autoriteteve të tjera kompetente, dokumentacioni ruhet edhe për 5 (pesë) vjet të tjera nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ndërmjet klientit dhe subjektit apo nga data e transaksionit rastësor, por jo më shumë se 40 (dyzet) vjet nga data e secilit transaksion në veçanti apo data e mbledhjes së dokumentacionit, apo e kryerjes së analizës.

8. Dokumentacioni i parashikuar në këtë nen ruhet në formë shkresore ose elektronike, në varësi të mënyrës së krijimit.

9. Të dhënat e siguruara për klientët (të përhershëm apo rastësorë) nga subjektet dhe masat e marra prej tyre në zbatim të ligjit, dokumentohen, administrohen rregullisht dhe vihen në dispozicion të autoritetit përgjegjës mbi bazë të kërkesës së këtij të fundit, në përputhje me nenin 21/1 të ligjit.

Neni 38
Dispozita të fundit

1. Ngarkohen subjektet e përcaktuara në nenin 3 për zbatimin e këtij udhëzimi dhe anekseve si pjesë organike të tij.

2. Për kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet autoriteti përgjegjës, Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF).

3. Ky udhëzim, së bashku me anekset I, II, III dhe IV dhe instruksionet përkatëse, do të jenë të vetmet standarde të pranueshme për raportim tek autoriteti përgjegjës. Nëse është e nevojshme në funksion të administrimit të të dhënave, njëtrajtshmërisë së raportimit për lloj subjektesh, ndërlidhjes me baza të tjera të dhënash, autoriteti përgjegjës mund të shtojë, pakësojë apo ndryshojë fusha të veçanta të anekseve pjese e këtij udhëzimi.

4. Udhëzimi nr. 29, datë 31.12.2012, "Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare", i ndryshuar, i ministrit të Financave, shfuqizohet.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

ANEKS I

RAPORTI I AKTIVITETIT TË DYSHIMTË (RAD)

1. Zgjidhni kutin me kombinime:

□ Pastrim parash □ Financim i terrorizmit □ Fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale
□ Pamundësi ushtrimi i vigjilencës së duhur □ Pamundësi ushtrimi i vigjilencës së zgjeruar

2. Zgjidhni kutin me kombinime:

□ Raport i ri □ Raportimet të lidhura □ Përmirëson një raport të mëparshëm;
□ Transfertë në Tentativë □ Bllokim (48 Orë)

PJESA I. INFORMACION MBI AKTIVITETIN E DYSHIMTË

1.Statusi ligjor i personit a.☐ Individ; b.☐ Person fizik tregtar c. ☐ Person juridik
d. ☐ Shoqëri Anonime e. ☐ OJF; f. ☐ Organizime Ligjore
g. ☐ SHPK (Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar) h.☐ Kujdestar i. ☐ Dege e shoqërisë se huaj;
j. ☐ PEP; k. ☐ Të tjera
2. a) Emri:_____ b. Mbiemri:_____
3. Datëlindja/data e regjistrimit: __.___._____
4. Shtetësia: a.☐ Shqiptar b.☐ I huaj c. ☐ Pa shtetësi
5. Vendlindja: _____
6. Adresa/ Vendbanimi i përhershëm _____
7. Vendbanimi i përkohshëm (nëse ka):_____
8. Gjinia : a. Mashkull ☐ b. Femër ☐

9. Dokumenti i identifikimit:
a) □ Letërnjoftim b) □ Pasaportë
10. Numri i dokumentit:_____
11. Nr. Personal i identifikimit (NID):_____
12.Autoriteti lëshues:_____

13. Emërtimi i Subjektit:_____ 14. NUIS/NIPT:_____
15. Selia e themelimit:_____ 16. Adresa e përkohshëm (nëse ka):_____
17. Punësim/lloji i aktivitetit:_____ 18. Nëse është PEP: ☐

PJESA II. PERSONAT E PËRFSHIRË Shto

PJESA III. VEPRIMI FINANCIAR I KRYER

1. Numri i transaksioneve:_____
2. Numri i llogarisë/ve: _____
3. Data e kryerjes së transaksionit ____.____._____
4. Monedha: Lek☐ Euro ☐ USD☐ GBP☐ JPY☐ CHF☐ CAD☐ Tjetër☐
5. Shuma e transaksionit: _____

PJESA IV. SHPJEGIME/PËRSHKRIME TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË

Shpjegime/ përshkrime të aktivitetit të dyshimtë: *Shënim: Të strukturohet në disa pika si më poshtë:* 1. Përshkrimi i profilit të subjektit të RAD; 2. Analiza totale e rastit duke përshirë dhe analizë të historikut të transaksioneve; 3. Anomalitë e vërejtura në transaksion, veprime apo veprimtari të dyshimta; 4. Dyshimet për rastin; 5. Lidhje me raste të tjera të raportuara të dyshimta, nëse ka; 6. Nëse kërkohen udhëzime nga AIF; 7. Të dhëna apo informacione të tjera me interes.
PJESA V. LISTA E DOKUMENTEVE SHOQËRUESE
PJESA VI. INFORMACION MBI SUBJEKTIN RAPORTUES
Emri: _____ Data e raportimit:____.____._____ Personi përgjegjës: _____ Tel._____ Firma: _____ E-mail._____ Aprovuesi: _____ Adresa: _____

INSTRUKSIONE PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT "RAPORTI I AKTIVITETIT TË DYSHIMTË" RAD

HYRJE

"Raporti i aktivitetit të dyshimtë" (RAD) është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, me anë të të cilit subjektet raportojnë tek autoriteti përgjegjës për çdo transaksion dhe aktivitet të dyshimtë. Ky formular plotësohet nga subjektet, për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit, apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale. Raportimi bëhet me anë të formularit (RAD) menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

1. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse aktiviteti dyshohet se ka të bëjë me pastrim parash, financim të terrorizmit apo fondet rrjedhin nga veprimtari kriminale.

2. Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse dërgohet te AIF, një raport i ri, një transfertë në tentativë apo bëhet përmirësim i një raporti të mëparshëm.

PJESA I
INFORMACION MBI AKTIVITETIN E DYSHIMTË

1. **Statusi ligjor i personit**: Me anë të zgjedhjes së një prej kutive, subjekti raportues jep informacion për statusin ligjor të personit/ave të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë sipas rastit individ, person fizik tregtar, person juridik, shoqëri anonime, OJF, organizime ligjore, SHPK (shoqëri me përgjegjësi të kufizuara), kujdestar, degë e shoqërisë së huaj.

2. **Emri, mbiemri**: për individin shkruhen emri dhe mbiemri.

3. **Datëlindja/data e regjistrimit (dd.mm.vvvv)**: nëse personi në emër të të cilit kryhet transaksioni/et është individ, shkruani datën e lindjes, përndryshe shkruhet data e regjistrimit të shoqërisë. Data shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes. Zero (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke. P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet në formatin 03.04.1978.

4. **Shtetësia**: shkruhet shtetësia e personit që kryen transaksionin (plotësohet në rastin e personave fizikë).

5. **Vendlindja**: shkruhet vendi (juridiksioni) ku personi ka lindur.

6. **Adresa/vendbanimi i përhershëm:** shkruhet adresa që deklarohet nga subjekti apo evidentohet në dokumentet e paraqitura prej tij.

7. **Vendbanimin e përkohshëm (nëse ka)**: plotësohet nëse personi ka një vend ku ai ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose kurs të caktuar, për t'u mjekuar, për të vuajtur një dënim penal dhe për raste të tjera të kësaj natyre.

8. **Gjinia: a) mashkull; b) femër:** shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse individi është mashkull apo femër.

9. **Dokumenti i identifikimit:** a) ☐letërnjoftim; b)☐ pasaportë;

Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas llojit të dokumentit të përdorur për të bërë identifikimin e personit.

10. **Numri i dokumentit:** këtu shkruhet numri i dokumentit të përdorur për identifikim.

11. **Numri personal i identifikimit (NID):** këtu shkruhet numri personal i identifikimit.

12. **Autoriteti lëshues**: këtu shkruhet autoriteti shtetëror që ka lëshuar dokumentin e përdorur për të bërë identifikimin e personit.

13. **Emërtimi i subjektit:** këtu shkruhet emri i subjektit.

14. **NUIS/NIPT:** shkruhen numri unik i identifikimit të subjektit ose numri i identifikimit të personit të tatueshëm.

15. **Selia e themelimit**: plotësohet vendi i selisë të themelimit të klientit sipas dokumenteve të paraqitura prej tij.

16. **Adresa e përkohshme (nëse ka):** plotësohet nëse personi ka një vend veprimtarie të ndryshëm nga adresa e themelimit.

17. **Punësim/lloji i aktivitetit:** jepet përshkrimi i punësimit ose llojit të aktivitetit të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

18. **Nëse është PEP:** shënohet një kryq në kutinë përkatëse nëse subjekti është person i ekspozuar politikisht.

PJESA II
PERSONAT E PËRFSHIRË

Në këtë pjesë të raportit jepen të dhënat mbi personat e përfshirë në transaksion.

PJESA III
VEPRIMI FINANCIAR I KRYER

1. **Numri i transaksioneve:** shkruhet numri i transaksioneve të kryera apo të tentuara.

2. **Numri i llogarisë/ve:** shkruhen numri/at e llogarive të përfshira në aktivitetin e dyshimtë.

3. **Data e kryerjes së transaksionit:** data e transaksionit shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin. Zeroja (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke. P.sh. nëse data e transaksionit është 5 maj 2008, në raport duhet të shkruhet 05.05.2008.

4. **Monedha:** vihet një kryq në një prej kutive sipas llojit të monedhës së përdorur për kryerjen e transaksionit p.sh.: LEK, USD, GBP, EUR etj.

5. **Shuma e transaksionit:** shkruhet shuma për transaksion të vetëm ose për disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën.

PJESA IV
SHPJEGIME/PËRSHKRIME TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË

Në këtë pjesë të raportit subjekti raportues bën një përshkrim të aktivitetit dhe të arsyeve për dyshim. Informacioni i përcjellë duhet të strukturohet në disa pika, si duke përfshirë, përshkrimin e profilit të

subjektit të RAD; analizën totale të rastit, duke përshirë dhe analizë të historikut të transaksioneve; anomalitë e vërejtura në transaksion, veprime apo veprimtari të dyshimta; dyshimet për rastin; lidhje me raste të tjera të raportuara të dyshimta, nëse ka; nëse kërkohen udhëzime nga AIF apo të dhëna apo informacione të tjera me interes.

Limiti i karaktereve është vendosur për të siguruar përditësimin e informacioneve voluminoze që hyjnë në data bazë, p.sh. tabela, figura; materialet mbi këtë limit mund të përcillen të zipuara te pjesa V.

PJESA V
LISTA E DOKUMENTEVE SHOQËRUESE

Në këtë pjesë të raportit vendosen të zipuara (deri në 10.MB ZIP) dokumentet që shoqërojnë raportin.

PJESA VI
INFORMACION MBI SUBJEKTIN RAPORTUES

Në këtë pjesë të raportit shkruhen të dhënat rreth subjektit raportues, si: emri i subjektit, emri dhe firma e personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave, emri i personit që bën aprovimin e raportit RAD (në rastet kur është i ndryshëm nga personi përgjegjës), data e raportimit në formatin (dd.mm.vvvv), si dhe numrin e telefonit/adresën e *email*-it, si dhe adresën e personit përgjegjës me anë të të cilit autoriteti përgjegjës mund të japë instruksione të mëtejshme në lidhje me raportin e paraqitur.

ANEKS II
RAPORTI I TRANSAKSIONEVE NË PARA FIZIKE (RTPF)

Në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 milion (1,000,000) lek

1. Zgjidhni kutinë e duhur:
☐ Raporti i Ri; ☐ Përmirëson një transaksion të mëparshëm; ☐Transaksione të lidhura
PJESA I. PERSONAT E PËRFSHIRË NË TRANSAKSION
SEKSIONI A. PERSONI QË KRYEN TRANSAKSIONIN
1.Statusi ligjor i personit: a. ☐ Individ; b.☐ Person fizik tregtar; ☐ c. Person juridik d. ☐Shoqëri Anonime e; OJF ☐ f. Organizime Ligjore ☐ g. ☐ SHPK (Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar) ☐ h. Kujdestar ☐ i. Dege e shoqërisë se huaj ☐ j. SHKK ☐ k. Tjetër ☐ 2. a) Emri:_____ b. Mbiemri:_____ 3. Datëlindja/data e regjistrimit: __.____._____ 4. Shtetësia: a.☐ Shqiptar ☐ b. I huaj ☐ c. Pa shtetësi 5. Vendlindja: _____ 6.Adresa:_____ 7. Gjinia: : a.☐ Mashkull; b. ☐ Femër
8. Dokumenti i identifikimit: a) ☐ Letërnjoftim; b) ☐ pasaportë; c) ☐ Nr. Personal(NID) 9. Numri i dokumentit:_____ 10.Autoriteti lëshues:_____
11. Emërtimi i Subjektit:_____ 12. NUIS/NIPT:_____ 13. Selia e themelimit:_____ 14. Adresa e përkohshëm (nëse ka):_____ 15. Punësim/lloji i aktivitetit:_____
SEKSIONI A.1-PERSONI I PERFSHIRË NË KRYERJEN E TRANSAKSIONIT Shto
PJESA II. PERSONI/AT PËRFITUES
SEKSIONI B. PERSONI/AT PERFITUES

1.Statusi ligjor i personit: a. ☐ Individ; b. ☐ Person fizik tregtar c. ☐ Person juridik;
d. ☐ Shoqëri Anonime; e. ☐ OJF f. Organizime Ligjore ☐
g. ☐ SHPK (Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar) h. ☐ Kujdestar ☐
i. Dege e shoqërisë se huaj ☐ j. SHKK ☐ k. Tjetër ☐
2. a) Emri:_____ b. Mbiemri:_____
3. Datëlindja/data e regjistrimit: __.____._____
4. Shtetësia: a. ☐ Shqiptar b. ☐ I huaj; 5. Vendlindja: _____
6.Adresa :_____7. Gjinia: : a. ☐ Mashkull b. ☐ Femër

8. Dokumenti i identifikimit:
a) ☐ Letërnjoftim; b) ☐ pasaportë
9. Numri i dokumentit:_____
10. Nr. Personal i identifikimit (NID):_____
11. Autoriteti lëshues:_____

12. Emërtimi i Subjektit:_____ 13. NUIS/NIPT:_____
14. Adresa e themelimit:_____ 15. Adresa e përkohshëm (nëse ka):_____
16. Punësim/lloji i aktivitetit:_____

SEKSIONI B.1- PERSONI/AT PËRFITUES I PËRFSHIRË

Shto

PJESA III. TRANSAKSIONI FINANCIAR I KRYER

1. Numri i transaksioneve:_____
2. Lloji i transaksionit
a) ☐ Depozitë Kredi b) ☐ Tërheqje cash c) ☐ Derdhje cash; d) ☐ Pagesa Këmbim valutor e) ☐ Shitje/Blerje letrash me vlerë f) ☐ Shitje/Blerje aksionesh
g) ☐ Pasuri e blerë/shitur h) ☐ Shitje kuotash; i) ☐ Kalim Fondesh
j ☐ Huadhënie k) ☐ Huamarrje l) ☐ Dhurim m) ☐ Tjetër
3. Data e transaksionit _____._____._____
4. Monedha: Lek ☐ Euro ☐ USD ☐ GBP ☐ JPY ☐ CHF ☐ CAD ☐ Tjetër
5. Shuma e transaksionit: _____
6. Shënim për transaksionin:_____

PJESA IV. INFORMACION MBI SUBJEKTIN RAPORTUES:

Emri: _____ Data e raportimit:_____._____._____
Personi përgjegjës: _____ Tel._____
Firma: _____ Email._____
Aprovuesi: _____ Adresa: _____

INSTRUKSIONET
PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË FORMULARIT TË RAPORTIMIT TË TRANSAKSIONEVE NË PARA FIZIKE
(Për transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 milion lekë)

Formulari i raportimit të transaksioneve në para fizike (RTPF), është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Me anë të këtij formulari bëhet raportimi nga subjektet i transaksionit/eve në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 milion lek (ose kundërvlera në një monedhë tjetër).

Bëni një kryq në kutinë/të sipas rastit të raportimit që bëhet (p.sh.: raportim i ri, përmirësim i një raportimi të mëparshëm ose bëhet fjalë për transaksione të lidhura të kryera brenda afatit të përcaktuar në këtë udhëzim).

PJESA I
PERSONAT E PËRFSHIRË NË TRANSAKSION

Seksioni A. Plotësohet në të gjitha rastet

Nëse personi kryen një transaksion në emër të vet, plotësoni seksionin A dhe lëreni seksionin B, bosh.

Nëse një individ kryen një transaksion në emër e tij dhe të personit/ave të tjerë, plotësoni seksionin A me të dhënat e mëposhtme për personin që kryen transaksionin dhe seksionin B për personin në emër të të cilit kryhet transaksioni.

1. **Statusi ligjor i personit:** me anë të zgjedhjes së një prej kutive, subjekti raportues jep informacion për statusin ligjor të personit/ave të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë sipas rastit individ, person fizik tregtar, person juridik, shoqëri anonime, ent publik, OJF, organizime ligjore, SHPK (shoqëri me përgjegjësi të kufizuara), kujdestar, degë e shoqërisë së huaj.

2. **Emri, mbiemri:** për individin shkruhen emri dhe mbiemri.

3. **Datëlindja/data e regjistrimit (dd.mm.vvvv):** nëse personi në emër të të cilit kryhet transaksioni/et është individ, shkruani datën e lindjes, përndryshe shkruhet data e regjistrimit të shoqërisë. Data shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes. Zero (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke. P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet në formatin 03.04.1978.

4. **Shtetësia:** shkruhet shtetësia e personit që kryen transaksionin (plotësohet në rastin e personave fizikë).

5. **Vendlindja:** shkruhet vendi (juridiksioni) ku personi ka lindur.

6. **Adresa:** shkruhet adresa që deklarohet nga subjekti apo evidentohet në dokumentet e paraqitura prej tij.

7. **Gjinia: a) mashkull; b) femër:** shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse individi është mashkull apo femër.

8. **Dokumenti i identifikimit:** a) □ letërnjoftim; b) □ pasaportë; c) □ nr. personal (NID).

Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas llojit të dokumentit të përdorur për të bërë identifikimin e personit.

9. **Numri i dokumentit:** këtu shkruhet numri i dokumentit të përdorur për identifikim, si dhe numri personal.

10. **Autoriteti lëshues:** këtu shkruhet autoriteti shtetëror që ka lëshuar dokumentin e përdorur për të bërë identifikimin e personit.

11. **Emërtimi i subjektit:** këtu shkruhet emri i subjektit.

12. **NUIS/NIPT:** shkruhen numri unik i identifikimit të subjektit ose numri i identifikimit të personit të tatueshëm.

13. **Selia e themelimit:** shkruhet adresa e plotë e zyrës qendrore të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

14. **Adresa e përkohshme (nëse ka):** plotësohet nëse personi ka një vend veprimtarie të ndryshëm nga adresa e themelimit.

15. **Punësim/lloji i aktivitetit:** jepet përshkrimi i punësimit ose llojit të aktivitetit të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

Seksioni A.1. Personi i përfshirë në kryerjen e transaksionit

Në këtë seksion shtohen të dhënat për personat e tjerë që janë të përfshirë si palë me personin që kryen transaksionin e raportuar.

PJESA II
PERSONI/AT PËRFITUES

Në këtë pjesë subjekti raportues jep të dhëna të plota për përfituesin në rastet kur ai është i ndryshëm nga personi në seksionet A dhe B.

Seksioni B. Personi në emër të të cilit kryhet transaksioni

Ky seksion plotësohet në të gjitha rastet kur personi/at që kryejnë transaksionin/et, janë të ndryshëm nga ata në emër të të cilëve kryhet transaksioni/et (p.sh. nëse një punonjës i X subjekti bën një depozitim për llogari të shoqërisë, kjo e fundit duhet të identifikohet në seksionin B dhe punonjësi që kryen transaksionin duhet të identifikohet në seksionin A).

Subjektet duhet të plotësojnë të gjitha të dhënat sipas mënyrës së plotësimit të përshkruar më sipër në seksionin A.

1. **Statusi ligjor i personit:** me anë të zgjedhjes së një prej kutive, subjekti raportues jep informacion për statusin ligjor të personit/ave të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë sipas rastit individ, person fizik tregtar, person juridik, shoqëri anonime, ent publik, OJF, organizime ligjore, SHPK (shoqëri me përgjegjësi të kufizuara), kujdestar, degë e shoqërisë së huaj.

2. **Emri dhe mbiemri:** për individin shkruhen emri dhe mbiemri.

3. **Datëlindja/data e regjistrimit (dd.mm.vvvv):** nëse personi në emër të të cilit kryhet transaksioni/et është individ, shkruani datën e lindjes, përndryshe shkruhet data e regjistrimit të shoqërisë. Data shkruhet në formatin tetëshifror. Dy shifrat e para tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin e lindjes. Zero (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke. P.sh. nëse data e lindjes së një individi është 3 prill 1978, në raport duhet të shkruhet në formatin 03.04.1978.

4. **Shtetësia:** shkruhet shtetësia e personit që kryen transaksionin (plotësohet në rastin e personave fizikë).

5. **Vendlindja:** shkruhet vendi (juridiksioni) ku personi ka lindur.

6. **Adresa:** shkruhet adresa që deklarohet nga subjekti apo evidentohet në dokumentet e paraqitura prej tij.

7. **Gjinia: a) mashkull; b) femër:** shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas rastit nëse individi është mashkull apo femër.

8. **Dokumenti i identifikimit:** a)☐ letërnjoftim; b)☐ pasaportë; c)☐nr. personal (NID).

Shënohet një kryq në kutinë përkatëse sipas llojit të dokumentit të përdorur për të bërë identifikimin e personit.

9. **Numri i dokumentit:** këtu shkruhet numri i dokumentit të përdorur për identifikim.

10. **Numri personal i identifikimit (NID):** këtu shkruhet numri personal i identifikimit.

11. **Autoriteti lëshues:** këtu shkruhet autoriteti shtetëror që ka lëshuar dokumentin e përdorur për të bërë identifikimin e personit.

12. **Emërtimi i subjektit:** këtu shkruhet emri i subjektit.

13. **NUIS/NIPT:** shkruhen numri unik i identifikimit të subjektit ose numri i identifikimit të personit të tatueshëm.

14. **Adresa e themelimit:** shkruhet adresa e plotë e zyrës qendrore të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

15. **Adresa e përkohshme (nëse ka):** plotësohet nëse personi ka një vend veprimtarie të ndryshëm nga adresa e themelimit.

16. **Punësim/lloji i aktivitetit:** jepet përshkrimi i punësimit ose llojit të aktivitetit të personit të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë.

Seksioni B.1. Personi/at përfitues

Në ketë seksion shtohen të dhënat për personat që janë përfitues nga transaksioni i raportuar.

PJESA III
TRANSAKSIONI FINANCIAR I KRYER

1. **Numri i transaksioneve:** shkruhet numri i transaksioneve të kryera për një transaksion të vetëm ose për disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën, shuma e agreguar e të cilave është e barabartë apo e kalon vlerën e 1 milion lek apo kundërvlerën në monedha të huaja. Afati kohor për llogaritjen e transaksioneve të lidhura është 24 orë.

2. **Lloji i transaksionit:** shënohet me kryq lloji i transaksionit (p.sh. depozitë kredi, tërheqje *cash*, derdhje *cash*, pagesa këmbim valutor etj.).

3. **Data e transaksionit:** shkruhet data e kryerjes së transaksionit në formatin ditë, muaj, vit (dd.mm.vvvv.) Zeroja (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke (p.sh. nëse data e transaksionit është 5 prill 2009, në raport duhet të shkruhet 05.04.2009.). Për subjektet të cilat bëjnë dhe regjistrimin e orës së transaksionit shkruhet, gjithashtu, dhe ora.

4. **Monedha:** bëhet një kryq në një prej kutive sipas llojit të monedhës së përdorur për kryerjen e transaksionit (p.sh. lek, USD, GBP, EUR etj.).

5. **Shuma e transaksionit:** shkruhet e plotë e transaksionit të kryer në para fizike në lek për një transaksion të vetëm ose për disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën, shuma e agreguar e të cilave është e barabartë apo e kalon vlerën e 1 milion lek apo kundërvlerën në monedha të huaja. Afati kohor për llogaritjen e transaksioneve të lidhura është 24 orë.

6. **Shënim për transaksionin:** në këtë pjesë të raportit subjekti raportues jep shënime lidhur me transaksionin.

PJESA IV
INFORMACION MBI SUBJEKTIN RAPORTUES

Në këtë pjesë plotësohen të dhëna rreth subjektit raportues, si: emri, mbiemri për personat fizikë (ose emri i plotë ligjor i shoqërisë për personat juridikë) emri i personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave, data e raportimit në formatin (dd.mm.vvvv), numrin e telefonit/adresën elektronike të personit përgjegjës më anë të të cilit autoriteti përgjegjës mund të japë instruksione të mëtejshme në lidhje me raportin e paraqitur, emrin e aprovuesit, si dhe adresën e plotë të subjektit.

ANEKS III
RAPORTI I KONTROLLIT NË DISTANCË (RKD)

EMRI I SUBJEKTIT RAPORTUES: _____
KATEGORIA E SUBJEKTIT: _____
PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT TË SUBJEKTIT: _____
ADRESA: _____
NUMRI I PUNONJËSVE TË SUBJEKTIT: _____
EMRI I PERSONIT PËRGJEGJËS/POZICIONI:
Tel.: ..... Fax: ..... *Email*: .....

I. Masat parandaluese të marra nga subjekti në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit:

1. A keni rregullore të brendshme?
Po __ Jo __

Nëse Po, bashkëngjisni kopje të rregullores.

2. A keni realizuar trajnime për punonjësit?
Po __ Jo __

Nëse Po:
- listoni temat e trajnimit dhe numrin e punonjëseve që kanë marrë pjesë në trajnim;
- bashkëngjisni kopje të temave të trajtuara në trajnimet e realizuara.

3. Numri i kontrolleve të kryera nga kontrolli i brendshëm (nëse ka)?

Po __ Jo __

Nëse Po, bashkëngjisni kopje të raportit të kontrolleve të kryera (raportet e auditimit të brendshëm apo të jashtëm, etj.) përfshirë:

- mangësitë e konstatuara prej tyre (nëse ka);

- masat e marra për ndjekjen e rekomandimeve apo gjetjeve të evidentuara.

II. Shpjegoni mënyrën e kontrollit dhe verifikimit të listës të personave të shpallur dhe masat përkatëse të marra në zbatim të:

- ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar;
- ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

III. Raportime të kryera nga subjekti në nivel statistikor:

Evidento numrin e RTPF të dërguara pranë autoritetit përgjegjës: _____

Evidento numrin e RAD të dërguara pranë autoritetit përgjegjës: _____

EMRI I PERSONIT PËRGJEGJËS: _____ FIRMA:_____	DATA: ___.___._____;

INSTRUKSIONE
PËR PLOTËSIMIN E RAPORTIT TË KONTROLLIT NË DISTANCË

"Raporti i kontrollit në distancë" është formulari që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe plotësohet nga subjektet me kërkesën e autoritetit përgjegjës me të dhënat mbi masat e marra për zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Formulari i plotësuar dhe dokumentacioni bashkëngjitur i dërgohet Agjencisë të Inteligjencës Financiare (AIF), brenda afateve kohore të përcaktuara në kërkesë.

Emri i subjektit raportues: Shkruhet emri i plotë i subjektit raportues.

Kategoria e subjektit: Në këtë pjesë të raportit shkruhet kategoria së cilës i përket subjekti në bazë të nenit 3, të ligjit nr. 9917/2008, të ndryshuar.

Përshkrimi i aktivitetit të subjektit: në këtë pjesë të raportit citohet fusha e veprimtarisë së subjektit.

Adresa: Shkruhet adresa e plotë e subjektit raportues.

Numri i punonjësve: Në këtë pjesë jepet numri i punonjësve të subjektit, duke e vërtetuar këtë me dokumentacionin përkatës.

Emri i personit përgjegjës/pozicioni: Shkruhet emri i personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, dhe përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë në subjektin raportues, si edhe pozicioni i tij në hierarkinë e subjektit.

Gjithashtu, jepen të dhëna e tij si numri i telefonit/faksit dhe adresa elektronike.

Masat parandaluese të marra nga subjekti në kuadër të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit: Në këtë pjesë të raportit subjekti raportues bën një paraqitje të masave të marra për zbatimin e ligjit (kryesisht neni 11, i ligjit nr. 9917/2008, "Masat parandaluese") dhe të akteve nënligjore. Duke vërtetuar këtë me dokumentacionin përkatës që duhet të shoqërojë këtë raport.

Rregullore të brendshme: Subjekti evidenton nëse ka të miratuar rregullore në kuadër të detyrimeve të ligjit nr. 9917/2008, të ndryshuar, duke e vërtetuar këtë me dokumentacionin përkatës që duhet të shoqërojë plotësimin e këtij raporti.

Trajnimet e personelit: Subjekti mund të përshkruajë trajnimet e kryera për personelin dhe numrin e tyre që kanë marrë pjesë në trajnim, si dhe evidenton nëse ka paraqitur ndonjë kërkesë për trajnim dhe

asistencë nga AIF-ja. Subjekti e shoqëron plotësimin e këtij raporti duke e vërtetuar me dokumentacionin përkatës.

Mënyra e kontrollit dhe verifikimit të listës së personave të shpallur dhe masat përkatëse të marra: Subjekti në këtë pjesë të raportit shpjegon mënyrën e kontrollit dhe verifikimit të listës të personave të shpallur dhe masave të mara në bazë dhe zbatim të ligjit 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar (kryesisht të fokusuar tek nenet 10–10/1) dhe ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (kryesisht të fokusuar te nenet 8–11).

Raportimet e bëra nga subjekti: Shkruhen të dhënat e subjektit për raportet e dërguara pranë Agjencisë të Inteligjencës Financiare (p.sh. numri i raporteve RTPF dhe RAD).

Emri i personit përgjegjës: Shënohet emri i personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave.

Firma: Raporti firmoset nga ana e personit përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave përpara se të dërgohet tek "autoriteti përgjegjës".

Data: Subjekti shënon datën e dërgimit të raportit tek "autoriteti përgjegjës" e cila duhet të shkruhet në tetë shifra. Dy të parat tregojnë datën kalendarike të muajit, dy të dytat tregojnë muajin kalendarik dhe katër të fundit tregojnë vitin. Zeroja (0) duhet t'i paraprijë çdo shifre teke. P.sh. nëse data është 3 prill 2003, në raport duhet të shkruhet 3.4.2003.

ANEKS IV
PËR REGJISTRIMIN DHE MBAJTJEN E TË DHËNAVE MBI KLIENTËT DHE TRANSAKSIONET

Të dhënat e mëposhtme janë informacionet thelbësore dhe të detyrueshme që subjekti duhet të përfshijë në sistemin e centralizuar.

Subjekti mund të shtojë dhe të dhëna të tjera që mund të lidhen me natyrën apo veçoritë specifike të aktivitetit të tij.

Emri (klientit ose pronarit përfitues)
Mbiemri
Datëlindja
Vendlindja
Nr. personal i identifikimit (NID)
Lloji i dokumentit
Emri i shoqërisë
NIPT/NUIS
Adresa
Shuma e transaksionit
Monedha
Lloji i transaksionit (p.sh.: derdhje/tërheqje/transfertë)
Data e transaksionit
Mënyra e kryerjes së transaksionit (p.sh. *cash* (para fizike)/transfertë)
Burimi i deklaruar i fondeve
Persona të tjerë të përfshirë (me gjeneralitete të plota)
Të dhënat identifikuese të pronarit përfitues të klientit

ANEKS V
SHEMBUJ ORIENTUES PËR PËRCAKTIMIN E PRONARIT PËRFITUES

Në vijim janë dhënë disa shembuj për subjektet e këtij udhëzimi, si një mundësi orientuese për ta, gjatë procesit të identifikimit dhe verifikimit të pronarit apo pronarëve përfitues të klientëve të tyre.

Shembulli 1



Subjekteve u kërkohet të përcaktojnë individët, të cilët zotërojnë në mënyrë direkte ose indirekte 25% ose më tepër të aksioneve të kompanisë A.

Në nivelin e parë, individi 1 zotëron 30% të aksioneve në kompaninë A dhe rrjedhimisht është pronar përfitues.

Në nivelin e dytë vetëm individi **4** është pronar përfitues, pasi ai së fundmi zotëron 30% të aksioneve të kompanisë A (duke qenë se ai zotëron 50% të aksioneve të kompanisë C, e cila nga ana tjetër zotëron 60% të aksioneve të kompanisë A). Individët 2, 3 dhe 5 zotërojnë respektivisht 10%, 12% dhe 18% të aksioneve të kompanisë A, kështu që nuk është e domosdoshme të identifikohen.

Shembulli 2



Subjekteve u kërkohet të identifikojnë individin, të cilët së fundmi zotërojnë 25% ose më tepër të aksioneve të kompanisë A.

Në nivelin e parë, individi 1 zotëron 30% të aksioneve në kompaninë A dhe rrjedhimisht është pronar përfitues.

Në nivelin e dytë vetëm individi 3 është pronar përfitues pasi ai së fundmi zotëron 26% të aksioneve të kompanisë A (duke qenë se ai zotëron 50% të aksioneve të kompanisë C, e cila nga ana tjetër zotëron 52% të aksioneve të kompanisë A).

Në nivelin e tretë, individi 4 është pronar përfitues, pasi ai së fundmi zotëron 33.6% të aksioneve në kompaninë A (duke qenë se ai zotëron 18% të aksioneve të kompanisë A nëpërmjet kompanive B dhe X, si dhe 15.6% të aksioneve të kompanisë A nëpërmjet kompanisë C dhe kompanisë Y).

Shembulli 3



Në rastin kur pronësia është e shpërndarë, asnjë ortak/aksionar nuk zotëron 25% ose më tepër të aksioneve, si pronar përfitues do të regjistrohet përfaqësuesi ligjor i shoqërisë.

Në rastin kur pronësia është e shpërndarë, asnjë ortak/aksionar nuk zotëron 25% ose më tepër të aksioneve, si pronar përfitues do të regjistrohet personi në nivelin më të lartë drejtues të shoqërisë.

Shembull 4

Në rastet kur klienti apo pronari përfitues është një kompani aksionare e listuar në një bursë të njohur dhe është subjekt i detyrimeve për raportim në një autoritet rregullator, regjistrohen si pronarë përfitues përfaqësuesit ligjorë të entitetit të listuar në bursë.

Për qëllime të këtij udhëzimi, bursë e njohur financiare do të konsiderohen bursat e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), si dhe të Shqipërisë.

ANEKS VI
TREGUES PËR ANALIZIMIN E TRANSAKSIONEVE KOMPLEKSE ME VLERA TË LARTA TË PAZAKONTA PA QËLLIM TË DUKSHËM EKONOMIK DHE LIGJOR

Subjektet duhet të marrin në konsideratë treguesit e mëposhtëm, gjatë analizimit të transaksioneve komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor, por pa u kufizuar vetëm në to, si më poshtë:

1. Transaksioni konsiderohet të jetë kompleks, në rastet kur:

a) lloji i transaksionit është qartësisht në mospërputhje me madhësinë apo aktivitetin e personit juridik ose fizik, apo moshën e klientit;

b) transaksionet janë të pazakonta për shkak të madhësisë, natyrës, shpeshtësisë, ose mënyrës së kryerjes së tyre;

c) ka dallime të dukshme dhe të konsiderueshme mes çmimit të deklaruar të kontratave të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme dhe vlerave faktike në përputhje me çmimet referencë të tregut;

ç) marrëdhënia e biznesit përfshin transaksione, të cilat nuk janë në përputhje me ato të deklaruara nga klienti, të tilla si: financime private, përdorimi i çeqeve të mbajtësit ose pagesa të shpeshta apo të konsiderueshme me para në dorë, veçanërisht nëse transaksione të tilla nuk janë në përputhje me profilin ekonomik të individit ose shoqërisë;

d) klienti nuk jep shpjegime logjike për kontributin e një shume të konsiderueshme në para si garanci e dhënë për huamarrje, në vend të përdorimit të këtyre fondeve;

dh) kalimi i pasurisë së paluajtshme do të kryhet duke pretenduar pagesë të mëparshme me metale të çmuara apo kriptomonedha apo detyrime monetare, pa dokumente provuese.

2. Transaksioni konsiderohet të jetë në vlera të larta dhe të pazakonta, në rastet kur:

a) transaksionet veçanërisht kryhen nga shoqëri të krijuara rishtazi, vlera e të cilave nuk justifikohet nga fusha e veprimtarisë së klientit, apo nga të dhënat e tjera ekonomiko-financiare;

b) fonde të marra ose të dërguara në një vend të huaj, pa lidhje të dukshme midis vendit dhe klientit;

c) financimi bëhet nga palët e treta që lidhet me transaksionin apo pagesën e detyrimeve të tjera, pa asnjë lidhje të dukshme mes palëve apo justifikim nga pikëpamja ekonomike;

ç) fonde të marra ose të dërguara në vende me rrezik të lartë për pastrim parash ose financim të terrorizmit, të listuara nga autoriteti përgjegjës apo Këshilli i Ministrave, sipas pikës "f", të nenit 22 të ligjit.

3. Transaksioni konsiderohet se nuk ka qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor, në rastet kur:

a) klienti përdor shumë llogari bankare brenda ose jashtë vendit pa pasur ndonjë arsye ekonomiko-ligjore;

b) shpenzimet personale të klientit financohen nga një shoqëri, aktivitet biznesi apo institucion shtetëror, pa pasur ndonjë shpjegim apo arsye ekonomiko-ligjore;

c) zgjedhja e mënyrës së pagesës është përcaktuar në një datë shumë afër kohës së noterizimit të aktit, veçanërisht nëse nuk ka garanci që siguron kryerjen e pagesës;

ç) në kontratë është përcaktuar një periudhë jashtëzakonisht e shkurtër shlyerjeje pa dhënë asnjë shpjegim logjik apo justifikim ekonomik;

d) tjetërsime të njëpasnjëshme dhe të shpeshta të pasurisë nga një individ tek tjetri pa një shpjegim logjik për ndryshimin e pronësisë, të shoqëruara me rritje domethënëse të çmimit (p.sh. mbi 30% mbi çmimin referencë të zonës);

dh) blerja e pasurive nën vlerën referencë të tregut (p.sh. 30 % nën vlerë) dhe më pas rishitja e saj menjëherë ose brenda një afati të shkurtër (p.sh. 6 vite) në vlerë dukshëm më të lartë (p.sh. mbi 30% mbi çmimin referencë të zonës), pa pasur të dhëna të arsyeshme për këtë (p.sh. ristrukturim i pasurisë që ka çuar në rritje të vlerës).

UDHËZIM
Nr. 3, datë 21.1.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 29, DATË 18.12.2019, "PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E REGJISTRAVE SHTETËRORË TË GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës "g", të pikës 2, të nenit 7 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të vendimit nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe 'Profesor'", i ndryshuar, vendimit nr. 777, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore", i ndryshuar dhe urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1

1. Në udhëzimin nr. 29, datë 18.12.2019, "Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë", bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

a) Pika 1 e kreut III ndryshon si më poshtë:

"1. Institucionet e arsimit të lartë aplikojnë në portalin unik qeveritar e-Albania sipas formularit përkatës shoqëruar me dokumentacionin për çdo gradë shkencore apo titull akademik të lëshuar prej tyre.

a) Për regjistrimin e gradës shkencore "Doktor", aplikimi përmban:

i. emër, atësi, mbiemër, shtetësi, datëlindjen dhe gjininë e personit të cilit i jepet grada shkencore;

ii. formën e studimit;

iii. numrin e matrikullimit;

iv. temën e disertacionit;

v. datën e regjistrimit në studimet e Doktoratës;

vi. kopje elektronike të disertacionit në formatin Word dhe/ose PDF;

vii. linkun/adresën e faqes web në të cilin është publikuar disertacioni përkatës;

viii. numrin dhe datën e vendimit të jurisë/komisionit për dhënien e gradës shkencore "Doktor" dhe kopje të skanuar të këtij vendimi në formatin PDF, si dhe të procesverbalit (nëse është mbajtur një i tillë);

ix. fushën e studimit;

x. konfirmimin që është kryer kontrolli antiplagjiaturë i disertacionit të mbrojtur për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe njoftimin e programit/soft-it përkatës të përdorur;

b) Për regjistrimin e titullit akademik "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", aplikimi përmban:

i. emër, atësi dhe mbiemër, shtetësi, datëlindjen dhe gjininë e personit të cilit i jepet titulli akademik "Profesor i asociuar"/"Profesor";

ii. numrin dhe datën e vendimit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik dhe kopje të skanuar të këtij vendimi në formatin PDF, si dhe të procesverbalit (nëse është mbajtur një i tillë);

iii. numrin dhe datën e vendimit të fitimit të gradës shkencore "Doktor"/titullit akademik "Profesor i asociuar"".

b) Pika 2 e kreut IV, ndryshon si më poshtë:

"2. Specialisti/struktura përgjegjëse për plotësimin e regjistrit shtetëror përkatës, në rastet kur aplikimi i IAL-së nuk është sipas kërkesave të përcaktuara në kreun III, të këtij udhëzimi, njofton IAL-në për plotësimet e nevojshme, brenda një afati 10-ditor."

c) Pika 1 e kreut V, ndryshon si më poshtë:

"1. Aplikimi për regjistrimin e gradave shkencore apo titujve akademikë në regjistrin shtetëror përkatës trajtohet nga AKKSHI, pas plotësimit nga IAL-ja të kritereve dhe ndjekjes së procedurave të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi."

ç) Pika 4 e kreut V shfuqizohet.

d) Pas pikës 2, të kreut VI shtohet pika 2/1 me përmbajtje si më poshtë:

"2/1. Procedura e aplikimit sipas këtij udhëzimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania", zbatohet pasi ministria përgjegjëse për arsimin të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare përfundimin e zhvillimeve teknike për realizimin e procedurës në Sistemit Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor, ACRIS.

Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga AKKSHI, deri në momentin e implementimit dhe funksionalitetit të Sistemit Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor, ACRIS, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre.".

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Ana Kapaj

UDHËZIM
Nr. 4, datë 21.1.2025

PëR NJË SHTESË DHE NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 19.2.2018 "PËR GJENERIMIN DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 10, pika 1, germa "c", të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 6, datë 19.2.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", i ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

a) Pika 7 ndryshohet si vijon:

"7. IAL-të, nëpërmjet ndërveprimit me sistemin SMIAL, dërgojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA) listën e studentëve të regjistruar, për çdo cikël studimi, në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin, që përcakton procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në IAL, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.".

b) Pas pikës 9, shtohet pika 9/1 me përmbajte si më poshtë:

"9/1. Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga institucioni përgjegjës, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre dhe të dhënat pasqyrohen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL).".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Ana Kapaj

UDHËZIM
Nr. 5, datë 21.1.2025

PëR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 30.3.2020, "PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE PËRBËRËSE, FORMËN E DIPLOMËS OSE CERTIFIKATËS TË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE PROCEDURËS SË REGJISTRIMIT TË TYRE NË REGJISTRIN SHTETËROR TË DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 10 dhe 91, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 30.3.2020, "Për përcaktimin e elementeve përbërëse, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa si vijon:

a) Pikat 1, 2, 6, 8 dhe 10 të kreut III ndryshojnë si më poshtë:

"1. Regjistrimi fillestar i formave të diplomave dhe certifikatave të lëshuar nga IAL, si dhe çdo regjistrim tjetër i mëvonshëm, që ndryshon formën apo përmbajtjen e tyre, bëhet në bazë të aplikimit të IAL-së nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania".

2. Aplikimi për regjistrimin e formës së diplomës ose certifikatës shqyrtohet nga QSHA-ja. Formulari për regjistrimin e formës së diplomës, i nënshkruar prej rektorit të IAL-së, shoqërohet me:

a) vendimin e Senatit Akademik, shoqëruar me formën e miratuar të diplomës apo certifikatës që do të regjistrohet, si dhe suplementin e diplomës (nëse ka);

b) mandatpagesën për tarifën e regjistrimit në regjistrin shtetëror.

QSHA-ja siguron nëpërmjet ndërveprimit me institucionet përgjegjëse dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kopjen e statutit të IAL-së të miratuar dhe aktin e miratimit të tij;

b) kopjen e aktit të hapjes/riorganizimit (nëse ka) dhe kopjen e aktit të akreditimit të IAL-së ose kur afati i akreditimit ka përfunduar, kopjen e dokumentit, me anë të të cilit vërtetohet aplikimi në organin kompetent për akreditimin periodik institucional;

c) kopjen e aktit të hapjes/riorganizimit (nëse ka) të programit të studimit për të cilin lëshohet diploma, që regjistrohet dhe kopjen e aktit të akreditimit të programit të studimit për të cilin lëshohet diploma që regjistrohet, ose kopjen e dokumentit me anë të të cilit vërtetohet aplikimi në organin kompetent për akreditimin periodik të programit të studimit, me përjashtim të programit të studimit për të cilin legjislacioni në fuqi nuk parashikon akreditimin e tij.

...

6. QSHA-ja kryen regjistrimin e formës së diplomës ose certifikatës në Regjistrin shtetëror dhe lëshon vërtetimin përkatës me vulë elektronike për IAL-në. Ky vërtetim i dërgohet IAL-së nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania.

...

8. Në rast se pas verifikimeve, rezulton se nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat për regjistrim, të parashikuara në këtë udhëzim, QSHA-ja pezullon aplikimin dhe njofton IAL-në në portalin unik qeveritar e-Albania, për plotësimin ose ndreqjen e elementeve që pengojnë regjistrimin e formës së diplomës ose certifikatës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e njoftimit. Afati i procedurës së regjistrimit rifillon ditën

pasardhëse të plotësimit ose ndreqjes së këtyre elementeve, në portalin unik qeveritar e-Albania.

...

10. Refuzimi i aplikimit, i cili përmban shkakun e refuzimit, i njoftohet IAL-së nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania.".

b) Pas pikës 1, të kreut IV shtohet pika 1/1 me përmbajtje si më poshtë:

"*1/1. Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga ministria përgjegjëse për arsimin, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre.".*

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Ana Kapaj

UDHËZIM
Nr. 6, datë 21.1.2025

PëR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 17, DATË 22.7.2024 "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KUALIFIKIMIT TË PUNONJËSVE ARSIMORË"

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 59, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024. "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendës-ministrit të arsimit dhe sportit, znj. Orjana Osmani",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 17, datë 22.7.2024 "Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë", bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 1, e nenit 3, të kreut I ndryshon si më poshtë:

"1. Testimi i informatizuar do të zhvillohet nëpërmjet sistemit elektronik, Sistemit të Provimit të Shtetit".

b) Shkronja "a", e pikës 1, të nenit 17, të kreut III ndryshon si më poshtë:

"a) Licencë për ushtrimin e profesionit të mësuesit, në profilin përkatës.

Mësuesit që janë përjashtuar nga detyrimi i provimit të shtetit, ngarkojnë diplomë në fushën e mësuesisë ose diploma të arsimit të lartë të ciklit të parë dhe të dytë ose të barasvlershme me to, të ngjashme ose të përafërta me fushën përkatëse të mësimdhënies në arsimin parauniversitar, përfshirë edhe diplomat e kandidatëve që japin lëndët e muzikës, të arteve pamore, kërcimit dhe edukimi fizik.

Mësuesit ngarkojnë edhe diplomën për fitimin e gradës shkencore "Doktor" në fushën e edukimit, e drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës (nëse ka)".

c) Shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1 dhe shkronjat "a" dhe "ç", të pikës 2, të nenit 29, të kreut VI ndryshojnë si më poshtë:

"1. Për dosjen:

a) *kandidati ka të drejtë të ankohet nëpërmjet portalit e-Albania, në formularin e shërbimit përkatës, brenda 3 (tri) ditëve nga hedhja në sistem e pikëve të vlerësimit të dokumentacionit nga Komisioni;*

b) titullari i ZVAP-së shqyrton ankimin dhe ngarkon përgjigjen me nënshkrim elektronik nëpërmjet portalit e-Albania brenda pesë ditëve nga data e ankimit. Në rast të pranimit të plotë ose të pjesshëm të ankimit, pikët e rivlerësuara hidhen në sistem nga titullari.

2. *Për testimin e informatizuar:*

a) kandidati ka të drejtë të ankohet në QSHA, nëpërmjet portalit e-Albania, lidhur me rezultatin e testimit të informatizuar, brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e rezultatit të testimit të informatizuar;

…

ç) QSHA-ja i kthen përgjigje kandidatit mbi ankimin nëpërmjet portalin e-Albania, brenda 5 (pesë) ditëve pune."

ç) Në nenin 33, pas paragrafit të parë, të kreut VII, shtohet paragrafi i dytë me përmbajtje si më poshtë:

"Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga institucionet kompetente, lidhur me procedurën e aplikimit për kualifikimin e punonjësit arsimor dhe/ose e ankimit, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre".

d) Në shkronjën "a" të shtojcës nr. 5, togfjalëshi "*... nuk mund t'i llogariten më shumë se 7 pikë në vlerësimin e dosjes"* ndryshon në "*...nuk mund t'i llogariten më shumë se 10 pikë në vlerësimin e dosjes".*

dh) Në shkronjën "b" të shtojcës nr. 5 bëhen ndryshimet si më poshtë:

"b) Diplomë: për ciklin e tretë studimeve "Master ekzekutiv" ose ekuivalentë me të në fushën e edukimit (nëse ka)" : 5 pikë.

Diplomë: për fitimin e gradës shkencore "Doktor" në fushën e edukimit, e drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës (nëse ka)": 10 pikë."

Togfjalëshi në kolonën e pikëzimit që i përket shkronjës "b" ndryshon "*nga 8-10 pikë*" në "*5-10 pikë*".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit

Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Orjana Osmani

UDHËZIM
Nr. 7, datë 21.1.2025

PëR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 30.6.2023, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE TË NJËVLERSHMËRISË SË DËFTESAVE DHE TË DIPLOMAVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TË ARDHUR NGA JASHTË VENDIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4, të nenit 52, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Orjana Osmani",

UDHËZOJ:

Neni 1

1. Në udhëzimin nr. 13, datë 30.6.2023, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe të diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit", i ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimet si më poshtë:

a) Shkronjat "a" dhe "c" të pikës 2, të kreut II ndryshojnë si më poshtë:

"a) Formulari i aplikimit për dëftesat e përfundimit të arsimit bazë dhe dëftesa klase të arsimit parauniversitar plotësohen nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania", drejtuar ZVAP.

...

c) Formulari i aplikimit për diplomën e arsimit të mesëm të lartë plotësohet online në portalin unik qeveritar e-Albania, nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Parauniversitar (SMIP), drejtuar QSHA."

b) Nënpika "iii" e shkronjës "b", nënpika "iv" e shkronjës "d", të pikës 2 dhe pika 3, të kreut II shfuqizohen.

c) Në pikën 1, të kreut III togfjalëshi "…*brenda 45 ditëve*." zëvendësohet me togfjalëshin "…*brenda 30 ditëve*."

d) Pika 1.2, e kreut III shfuqizohet.

e) Pika 1.3, e kreut III ndryshon si më poshtë:

"1.3 Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacion, Komisioni i Njohjes së Dëftesave i kërkon aplikantit fillimisht plotësimin e dokumentacionit nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania", brenda 15 ditëve nga momenti i aplikimit. Në rast të mosdepozitimit të plotësimeve brenda këtij afati, aplikimi refuzohet."

f) Shkronja "c" e pikës 2, të kreut III ndryshon si më poshtë:

"c) Depoziton në dosjen e aplikantit materialet shkresore ose të printuara për të gjitha

verifikimet e kryera shkresore ose të printuara."

g) Në pikën 1, të kreut IV togfjalëshi "…*brenda 45 ditëve*." zëvendësohet me togfjalëshin "…*brenda 30 ditëve*."

h) Pika 1.6, e kreut IV ndryshon si më poshtë:

"1.6 Në rast të konstatimit të mangësive në dokumentacion, SNJD-ja i kërkon aplikantit fillimisht plotësimin e dokumentacionit nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania", brenda 15 ditëve nga momenti i aplikimit. Në rast të mosdepozitimit të plotësimeve brenda këtij afati, aplikimi refuzohet dhe paraqitet aplikim i ri."

i) Në pikën 1, të kreut VI togfjalëshi *"...ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim kundër vendimit..." zëvendësohet me togfjalëshin "...ka të drejtë të bëjë ankim në portalit unik qeveritar "e-Albania" kundër vendimit...""*.

j) Pas pikës 3 të kreut IV shtohet pika 3/1 me përmbajtje si më poshtë:

"3/1. Aplikimet dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga institucioni përgjegjës, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre."

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe Komisioni i Njohjes së Dëftesave dhe Komisioni i Njohjes së Diplomave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Orjana Osmani

UDHËZIM
Nr. 8, datë 21.1.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 3.4.2015, "PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E LICENCËS QË FITON KANDIDATI NË PËRFUNDIM TË PROVIMIT TË SHTETIT PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË MËSUESIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 9, pika 3 të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Orjana Osmani",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 3.4.2015, "Për përmbajtjen dhe formën e licencës që fiton kandidati në përfundim të provimit të shtetit për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesit", i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa si vijon:

a) Shkronja "l" e pikës 4 ndryshon si më poshtë:

"l) Nënshkrimin elektronik të Drejtorit të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe vulën elektronike të QSHA-së;".

b) Pika 8 ndryshon si më poshtë:

"8. Kandidati i suksesshëm në provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit, aplikon nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania" për pajisjen me licencën për ushtrimin e profesionit. QSHA-ja brenda 45 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit pajis aplikuesin me licencë. Licenca dërgohet si dokument me vulë elektronike, në llogarinë e tij në portalin unik qeveritar "e-Albania"."

c) Pikat 9 dhe 11 shfuqizohen.

d) Pas pikës 14, shtohet pika 14/1 me përmbajtje si më poshtë:

"*14/1. Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga institucionet përgjegjëse, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre.".*

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe drejtoritë rajonale arsimore parauniversitare/zyrat vendore arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Orjana Osmani

UDHËZIM
Nr. 9, datë 24.1.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 8, DATË 13.3.2017, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 9, pika 4 dhe nenit 10, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 18, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 9 dhe 10, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar" dhe urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024 "Për delegimin e kompetencave dhe

caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Ana Kapaj", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 8, datë 13.3.2017, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore", bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Shkronja "b" e pikës 4 ndryshon si më poshtë:

"b) Pranon aplikimet dhe bën njohjen dhe njësimin e diplomave të arsimit të mesëm të lartë, të nxënësve të ardhur nga jashtë vendit, sipas përcaktimeve në udhëzimin përkatës në fuqi. QSHA-ja administron dokumentacionin e këtij procesi në bazë të përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi."

b) Shkronja "c" e pikës 4 ndryshon si më poshtë:

"c) Pranon aplikimet dhe bën njohjen dhe njësimin e diplomave dhe certifikatave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, si dhe pranon aplikimet dhe koordinon procesin e shqyrtimit, lidhur me procedurat e njohjes së gradave dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit. QSHA-ja administron dokumentacionin e këtij procesi, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi."

c) Pika 11 ndryshon si më poshtë:

"11. QSHA-ja drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili mbështetet nga 2 (dy) zëvendësdrejtorë të përgjithshëm, të cilët emërohen me të njëjtat procedura si drejtori i përgjithshëm."

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, njësitë arsimore vendore, urdhrat profesionalë dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Ana Kapaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 549/1, datë 20.12.2024

PËR PROCEDURËN E PAGIMIT TË TARIFËS SË LICENCËS SË PRODHIMIT TË CANNABIS-it PËR QËLLIME MJEKËSORE DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË KËSAJ TARIFE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 14, pika 9, dhe nenit 43, të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *Cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale", ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

I. TË PËRGJITHSHME

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave dhe i përgjegjësive për pagesën e tarifës për pajisen me licencë për prodhimin e *Cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe për mënyrën e përdorimit të tarifës së licencimit.

II. VLERA DHE MËNYRA E PAGIMIT TË TARIFËS

1. Tarifa e përcaktuar në nenin 14, pika 9, të ligjit nr. 61/2023, "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *Cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale" është në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë. Kjo tarifë është e pakthyeshme.

2. Tarifa do të paguhet nga subjekti që kërkon të licencohet sipas faturës për arkëtim, referuar modelit të miratuar me urdhrin nr. 35, datë 11.11.2009, të ministrit te Financave, "Për miratimin e faturës për arkëtim".

3. Subjekti, për të proceduar me pagesën, shkarkon nga faqja *web* e Agjencisë faturën për arkëtim.

4. "Fatura për arkëtim", paraqitet nga subjekti në bankën e nivelit të dytë për të kryer pagesën.

5. Banka e nivelit të dytë do të pranojë arkëtimin e tarifës vetëm me paraqitjen e faturës së plotësuar me të dhënat sipas modelit bashkëlidhur.

6. Dokumenti i lëshuar nga banka, që vërteton kryerjen e pagesës, dorëzohet pranë Agjencisë

Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it së bashku me dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.

III. MËNYRA E PËRDORIMIT TË TARIFËS

Të ardhurat e përfituara nga kjo tarifë arkëtohen në llogarinë e të ardhurave të thesarit në favor të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it dhe përdoren sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 646, datë 16.10.2024, "Për procedurën dhe mënyrën e përdorimit të të ardhurave të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Albana Koçiu

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

URDHËR
Nr. 35, datë 21.1.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHTESË NË URDHRIN NR. 36, DATË 24.1.2023, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT SHTETËROR TË REVISTAVE SHKENCORE QË BOTOHEN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 60 dhe 79, të ligjit 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të pikës 3 të kreut V, të vendimit nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor"', të ndryshuar, të vendimit nr. 165, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë, të ndryshuar, si dhe urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024 "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Ana Kapaj", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 36, datë 24.1.2023, "Për miratimin e rregullores për krijimin e regjistrit shtetëror të revistave shkencore që botohen në Republikën e Shqipërisë", bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

a) Pikat 1, 3, 4 dhe 5 të nenit 7 ndryshojnë si vijon:

"1. Institucionet kërkimore shkencore ngarkojnë aplikimin në platformën e-Albania për përfshirjen e revistës/ave shkencore në regjistër.

...

3. Aplikimi kryhet në platformën e-Albania dhe përmban:

a) Formularin e aplikimit, i cili plotësohet në platformën e-Albania, me elementet e mëposhtme:

...

b) Dokumentacioni provues sipas elementeve të plotësuara në formular.

...

4. Regjistrimi fillestar i revistave të botuara nga institucionet kërkimore shkencore, si dhe çdo regjistrim tjetër i mëvonshëm, që ndryshon formën apo përmbajtjen e tyre, bëhet në bazë të aplikimit drejtuar AKKSHI, nëpërmjet platformës e-Albania.

5. Aplikimi shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vendimi i senatit të IAL-së, apo Këshillit Shkencor të institucionit kërkimor për miratimin e formës së revistës dhe periodicitetit, ngarkohen si kopje e skanuar me origjinalin;

b) Akti i hapjes së revistës ose numri më i vjetër i revistës qe disponon institucioni;

c) Akti i indeksimit të revistës;

d) Forma e revistës (design) që do të regjistrohet.".

b) Pas pikës 1, të kreut III, shtohet pika 1/1 me përmbajtje si më poshtë:

"*1/1. Procedura e aplikimit sipas këtij urdhri nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania, zbatohet pasi ministria përgjegjëse për arsimin të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare përfundimin e zhvillimeve teknike për realizimin e procedurës në Sistemit Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS).*

Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga AKKSHI, deri në momentin e implementimit dhe funksionalitetit të Sistemit Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS), trajtohen dhe zhvillohen sipas

dispozitave në fuqi të këtij urdhri, në kohën e paraqitjes së tyre.".

2. Ngarkohet zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe institucionet që kryejnë veprimtari shkencore në Republikën e Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT
DHE SPORTIT
Ana Kapaj

VENDIM
Nr. 14, datë 27.1.2025

PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARIT TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Bazuar në nenin 158 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar; si dhe nenet 5 dhe 8, të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë", Këshillit i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Zoti Erind Gërmenji zgjidhet zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më datë 27.1.2025.

KRYETAR
Mirela Bogdani

URDHËR
Nr. 23, datë 28.1.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 12, pika 1, dhe nenit 13, germa "b" e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe të nenit 7, pika 2, germa "c" e rregullores "Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar, në mungesë të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjyqtares Mimoza Tasi, për datën 31.1.2025. Kjo kompetencë nuk mund të nëndelegohet.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet gjyqtarja Mimoza Tasi dhe të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Sokol Çomo

VENDIM
Nr. 19, datë 20.1.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "EB ENERGY" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 191 prot., datë 17.1.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'EB Energy' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "EB Energy" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2659 prot., datë

31.12.2024, ka paraqitur kërkesën e saj dhe dokumentacion në format elektronik për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b" dhe "d"; për pikën 1.3, germat "a" dhe "c"; dhe për pikën 2.1, germat "a", "b", "c", "d", "e" dhe "f".

- Rezulton se shoqëria "EB Energy" sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), kontratën nr. 1952 rep., nr. 1263 kol., datë 6.4.2023, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier".

- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., nr. 5595/3 prot., datë 6.9.2024;

- Ka depozituar vendim për VNM paraprake, lëshuar më datë 18.7.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin "Ndërtimi i impiantit PV Fier EB Energy", me fuqi të instaluar 2 mw. Shoqëria ka bërë me dije se me marrjen e lejes së ndërtimit po ndërmerr të gjitha veprimet e duhura për respektimin e procedurave të fillimit të punimeve, por gjithsesi ajo disponon një VNM të vlefshme deri më datë 18.7.2026, për këtë arsye, duhet të fillojë punimet brenda këtij afati, në të kundërt duhet të depozitojë një VNM të re.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **germa "c":** shoqëria duhet të plotësojë strukturën organizative (organigramën) e saj dhe me stafin tjetër që do t'i shërbejë veprimtarisë në të ardhmen.

Pika 1.3, Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **germa "b":** shoqëria duhet të dokumentojë aftësinë financiare për mbulimin e pjesës së mbetur për realizimin e projektit fotovoltaik dhe, në zbatim të përcaktimeve të nenit 8.2 të kontratës me MIE-n, vlerësohet t'i kërkohet asaj të depozitojë në ERE njoftimin e dërguar MIE-s për ndryshimin e vlerës së investimit.

- Shoqëria duhet të depozitojë një dokument teknik, garancinë përkatëse për panelet fotovoltaike në lidhje me jetëgjatësinë e tyre nga ku do të llogaritet dhe afati i vlefshmërisë së licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "EB Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "EB Energy" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 20, datë 20.1.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "GREEN PLUS ENERGY" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "*Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE*-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 190 prot., datë 17.1.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "*Mbi kërkesën e shoqërisë 'Green Plus Energy' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike*",

konstatoi se:

- Shoqëria "Green Plus Energy" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2658 prot., datë 31.12.2024, ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacion në format elektronik për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b" dhe "d"; për pikën 1.3, germat "a" dhe "c"; dhe për pikën 2.1, germat "a", "b", "c", "d", "e" dhe "f".

- Rezulton se shoqëria "Green Plus Energy" sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), kontratën nr. 2429 rep., nr. 1574 kol., datë 28.4.2023, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier";

- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. nr. 5596/3 prot., datë 6.9.2024;

- Ka depozituar vendim për VNM paraprake, lëshuar më datë 17.7.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin "Ndërtimi i impiantit PV", nga shoqëria "Green Plus Energy" sh.p.k., me fuqi të instaluar 2 mw. Shoqëria ka bërë me dije se është në pritje të zbardhjes së lejes së ndërtimit dhe se po ndërmerr të gjitha veprimet e duhura për respektimin e procedurave të fillimit të punimeve. Ajo disponon një VNM të vlefshme deri më datë 17.7.2026, për këtë arsye duhet të fillojë punimet brenda këtij afati, në të kundërt do të duhet të depozitojë në ERE një VNM të re.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2, Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **germa "c":** shoqëria duhet të plotësojë strukturën organizative (organigramën) e saj dhe me stafin tjetër që do t'i shërbejë veprimtarisë në të ardhmen.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **germa "b":** shoqëria duhet të depozitojë në ERE njoftimin e dërguar MIE-s për ndryshimin e vlerës së investimit.

- Shoqëria duhet të depozitojë një dokument teknik (garancinë përkatëse) për panelet fotovoltaike në lidhje me jetëgjatësinë e tyre nga ku do të llogaritet dhe afati i vlefshmërisë së licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Green Plus Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Green Plus Energy" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 21, datë 20.1.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "MET ALBANIA" SHA NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e", dhe 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 53/2 prot., datë 17.1.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'MET Albania' sh.a. për licencim në veprimtarinë e tregtimi të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "MET Albania" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2497 prot., datë 5.12.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 282, datë 18.12.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 19.12.2024 dhe 20.12.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.12.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 2498/3 prot., datë 23.12.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të munguar.
- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2498/4 prot., datë 27.12.2024. Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, është konstatuar se ende ka dokumentacion që nevojitet të sqarohet/plotësohet. Për këtë arsye, ERE i është drejtuar shoqërisë me një e-mail të protokolluar me nr. 53 prot., datë 9.1.2025.
- Shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 53/1 prot., datë 14.1.2025.
- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b" dhe "c", për pikën 1.3, germat "a", "b" dhe "c", dhe pikën 2.5.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "MET Albania" sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "MET Albania" sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 22, datë 20.1.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "MET ALBANIA" SHA NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "d", 5, pika 1, germa "d", dhe 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 53/3 prot., datë 17.1.205, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'MET Albania' sh.a. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "MET Albania" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2498 prot., datë 5.12.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 282, datë 18.12.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 19.12.2024 dhe 20.12.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.12.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 2488/3 prot., datë 23.12.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka kërkuar plotësimin e informacionit / dokumentacionit të konstatuar të munguar.
- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2498/4 prot., datë 27.12.2024. Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, është konstatuar se ende ka dokumentacion që nevojitet të sqarohet/plotësohet. Për këtë arsye, ERE i është drejtuar shoqërisë me një e-mail të protokolluar me nr. 53 prot., datë 9.1.2025.
- Shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 53/1 prot., datë 14.1.2025.
- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b", dhe "c"; për pikën 1.3, germat "a", "b" dhe "c", dhe për pikën 2.4, germat "a", "b", "c" dhe "d".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "MET Albania" sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "MET Albania" sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 23, datë 20.1.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË "GEGA-G" SHPK PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e", 10, pikat 1 dhe 16 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 189 prot., datë 17.1.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'GEGA-G' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

Konstatoi se:

- Shoqëria "GEGA-G" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 64, datë 8.4.2020.

- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, brenda afateve të përcaktuara në nenin 16, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit dhe ka depozituar dokumentacion referuar kërkesave të nenit 16 të rregullores.

- Për sa depozituar nga shoqëria në lidhje me këtë aplikim dhe duke qenë se ajo nuk ka dhënë sqarime në lidhje me dokumentacionin që ka pësuar ndryshime apo modifikime, vlerësohet që t'i kërkohet në vijim në kuadër të informacionit shtesë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "GEGA-G" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "GEGA-G" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 194/3, datë 28.1.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: 'Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, Muzeu i Navigimit'".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Shkodër.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur sipas projektraportit LARP nr. 2049 prot., datë 29.5.2024, si dhe kontratës nr. 3960 prot., datë 4.12.2023, ndërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Operatorit ekonomik "Alb Tiefabau", me objekt të kontratës "'Transformimi urban në hapësira publike, faza II, 'Ndërhyrje në hyrje të Shkodrës dhe rikualifikimi i bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës'".

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Shkodër, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,575,495 (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "RIKUALIFIKIMI I HYRJES SË QYTETIT TË SHKODRËS DHE BREGUT PERËNDIMOR TË LIQENIT TË SHKODRËS, MUZEU I NAVIGIMIT"

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM								
													RAPORT VLERËSIMI LARP m² ZK 8591			Ndërtesë =0 lek/m² ZK 8591			Kostot e transaksionit	VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qyteti	Z. kadastrale	Indeksi i bartës	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Truall (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Vlera (lekë)		
	A	B	C	Ç	D	E	F		G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S
1	ARRSH			Shkodër	8591	S-4	18/803	TRUALL	315	**315**	61	110	315	0	0	0	0	0		0	
2	MUHARREM		SHKJAU	Shkodër	8591	S-4	18/804	TRUALL	155	**155**	61	111	155	10129	1,569,995	0	0	0	5,500	1,575,495	
3	SHTET			Shkodër	8591	S-4	18/36	RRUGË	1909	**1909**	10	37	452	0	0	0	0	0		0	
4	SHTET			Shkodër	8591	S-4	18/163	KULLOTË	1443	**1443**	36	19	685	0	0	0	0	0		0	
5	SHTET			Shkodër	8591	S-4	18/31	KANAL	2172	**2172**	10	32	293	0	0	0	0	0		0	
6	SHTET			Shkodër	8591	S-4	18/58	LUM	291270	**291270**	25	24	660	0	0	0	0	0		0	
	Vlera totale e shpronësimit												**2560**		**1,569,995**	0		**0**	**5,500**	**1,575,495**	

Mbyllet me numër rendor 6.
Shënim. Vlerësimi u realizua sipas projektraportit LARP nr. 2049, datë 29.5.2024.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me vendimin nr. 62-2024-6351 (706), datë 5.12.2024, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Ferdinant Mihaj, më datë 29.4.1954.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 304 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/02/03 15:59:56 +02'00'
2be8052fcbe4499aa3600951c347e103202502031
5594418031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)